



Republika e Kosovës-Republika Kosova-Republic of Kosovo
Autoriteti Rregullativ i Hekurudhave
Regulativni Autoritet Železnica
Railway Regulatory Authority



Raport vjetor 2017

Autoriteti Rregullativ i Hekurudhave; Rr.Rrustem Statovci nr.29, Prishtinë; Tel:038 220 040; Fax:038 22 33 44;

[web:www.arh-ks.org](http://www.arh-ks.org)

■ ■ ■ Përmbajtja

1	Përmbledhje ekzekutive.....	6
2	Korniza ligjore	10
2.1	BAZA EKZISTUESE LIGJORE QË RREGULLON ARH-NË	10
2.2	PËRMIRËSIMI I BAZËS LIGJORE NË PERIUdhËN RAPORTUESE	11
2.3	VËSHTRËSITË LIGJORE QË KA HASUR ARH NË PËRMBUSHJEN E MISIONIT TË VET	11
3	Përshkrimi i ARH-së	11
3.1	MISIONI/VIZIONI.....	12
4	Fushëveprimi institucional.....	14
4.1	STRUKTURA ORGANIZATIVE E ARH-SË.....	14
4.2	BORDI MBIKËQYRËS I ARH-SË	16
4.2.1	MANDATI	17
4.2.2	KOMPETENCAT.....	17
4.2.3	FUNKSIONALIZIMI	17
4.3	EKZEKUTIVI.....	18
4.3.1	DREJTORI I PËRGJITHSHËM I ARH-SË	18
4.3.2	MENAXHMENTI I MESËM.....	18
4.3.3	MANDATI	18
4.4	BURIMET NJERËZORE	19
4.4.1	NUMRI I PUNËTORËVE	19
4.4.2	NEVOJAT PËR PUNËTORË TË RINJ	19
4.4.3	NUMRI I TRAJNIMEVE DHE NEVOJAT PËR TRAJNIM	19
4.5	ASETET	28
4.5.1	ASETET NË POSEDIM TË INSTITUCIONIT	28
4.5.2	PLANET PËR ASETET TË REJA.....	28
4.6	PAGAT E PERSONELIT TË ARH-SË	28
5	Aktivitetet për periudhën raportuese	30
5.1	PËRSHKRIMI I SHKURTËR I FUSHËS QË MBULON ARH DHE NJË KRAHASIM ME TRI VITET E FUNDIT.....	30
5.2	PLANIFIKIMI DHE REALIZIMI I PUNËS 2017	34
5.3	VEPRIMET E ARH-SË PËR PËRMIRËSIMIN/MONITORIMIN E FUSHËS SË VEPRIMIT	37
5.4	SFIDAT E VITIT RAPORTUES DHE PLANIFIKIMI PËR VITIN VIJUES	38
6	Puna specifike e ARH gjatë vitit raportues.....	39
6.1	FUSHA LICENCIMIT.....	39
6.1.1	LICENCIMI I MAKINISTËVE	39
6.1.2	LICENCË PËR TRANSPORT TË UDHËTAREVE APO MALLRAVE.....	40
6.1.3	NJOHJA E LICENCËS EVROPIANE	40
6.1.4	INSPEKTIMI I MAKINISTËVE	40

6.1.5	MONITORIMI I LICENCAVE	41
6.1.6	AZHURNIMI I REGJISTRIT QENDROR TË LEJEVE	42
6.2	FUSHA E SIGURISË.....	43
6.2.1	PËRGATITJA E LEGJSLACIONIT SEKONДАР (AKTEVE NËNLIGJORE).....	43
6.2.2	SHQYRTIMI I APLIKACIONEVE PËR DHËNIEN E AUTORIZIMIT PËR FUTJEN NË SHËRBIM TË MJETEVE LËVIZËSE.....	44
6.2.3	PËRGATITJA E RAPORTIT VJETOR TË SIGURISË	45
6.2.4	INSPEKTIMI I INFRASTRUKTURËS HEKURUDHORE NË MENAXHIM TË INFRAKOS-IT	46
6.2.5	INSPEKTIMI I MJETEVE LËVIZËSE HEKURUDHORE NË MENAXHIM TË INFRAKOS-IT.....	48
6.2.6	INSPEKTIMI I MJETEVE LËVIZËSE HEKURUDHORE TË TRAINKOS-IT.....	49
6.2.7	INSPEKTIMI I MJETEVE LËVIZËSE HEKURUDHORE NË MENAXHIM TË RAILTRANS-IT	49
6.2.8	INSPEKTIMI I MJETEVE LËVIZËSE HEKURUDHORE NË MENAXHIM TË FERRONIKELIT	50
6.3	FUSHA E INTEROPERABILITETIT	50
6.3.1	MJETET HEKURUDHORE TË KOSOVËS QË GJENDEN JASHTË TERRITORIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS	50
6.3.2	REGJISTRIMI I MJETEVE LËVIZËSE HEKURUDHORE	52
6.3.3	KRIJIMI I DATAZËS PËR MJETET ME PRONËSI TË PA DEFINUAR	54
6.3.4	AZHURNIMI I REGJISTRIT TË MJETEVE LËVIZËSE NVR.....	55
6.3.5	AZHURNIMI I MARRËVESHJEVE NDËRKOMBËTARE DHE VENDORE TË NDËRMARRJEVE HEKURUDHORE	56
6.3.6	LIBRI I RREGULLAVE PËR MAKINISTË	58
6.3.7	SPECIFIKACIONET TEKNIKE PËR INTEROPERABILITET (STI).....	59
6.3.8	SPECIFIKACIONET TEKNIKE PËR INTEROPERABILITET PËR NËNSISTEMIN E INFRASTRUKTURËS (STI INF)	59
6.3.9	INSPEKTIMI I REGJISTRIT TË MJETEVE LËVIZËSE.....	60
6.3.10	SHËNJIMI I NUMRIT EVROPIAN NË MJETIN LËVIZËS.....	61
6.3.11	SHËNJIMI I MBAJTËSIT TË MJETIT LËVIZËS (VKM)	61
6.3.12	INSPEKTIMI I SHËNJIMIT TË MBAJTËSIT TË MJETIT LËVIZËS	63
6.4	FUSHA E RREGULLIMIT TË TREGUT	63
6.4.1	PROCESI I KONSULTIMIT PËR EKSPOZEUN E RRJETIT.....	63
6.4.2	SHQYRTIMI I ANKESAVE.....	64
6.4.3	RAPORTI PËR MONITORIMIN E TREGUT HEKURUDHORË	67
6.5	FUSHA LIGJORE	67
6.6	ADMINISTRATA	71
6.7	FINANCAT	71
6.7.1	PASQYRAT FINANCIARE	72
6.8	PROKURIMI	80
6.9	MARRËDHËNIET ME PUBLIKUN DHE QASJA NË DOKUMENTE PUBLIKE.....	80
7	Raporti Financiar	84
8	Raportimi rreth adresimit të rekomandimeve të zyrës së auditorit të përgjithshëm.....	84
9	Shtojcat.....	86
9.1	PËRSHKRIMI I HEKURUDHAVE TË KOSOVËS.....	86
9.1.1	HARTA E HEKURUDHAVE TË KOSOVËS.....	87

Shkurtesat

ARH	Autoriteti Rregullativ i Hekurudhave
MI	Ministria e Infrastrukturës
MF	Ministria e Financave
HK	Hekurudhat e Kosovës
INFRAKOS	Infrastruktura e Hekurudhave të Kosovës
TRAINKOS	Operimi me Trena të Hekurudhave të Kosovës
RAILTRANS	Operator per transport te mallrave
ERR	Ekspozeu i Rrjetit
IRG-Rail	Indenpedent Regulatorys Group-Rail
BE	Bashkimi Evropian
AQP	Agjencia Qendrore e Prokurimit
KRPP	Komisioni rregullativ i prokurimit publik
BKK	Buxheti i Kosovës
OB	Organizatat Buxhetore
ERA	European Union Agency for Railway (Agjensioni i Bashkimit Evropian i Hekurudhave)
SEETO	South-East Europe Transport Observatory (Observatori i Transportit të Evropës Juglindore)
OTIF	<u>Organisation intergouvernementale pour les Transports Internationaux Ferroviaires</u> (Organizimi Qeveritar për Transportet Ndërkombëtare Hekurudhore)
IPA	Instrumenti për Ndihmën e Para-Anëtarësimit
SMS	Safety Managment Sistem (Sistemi i Menaxhimit të Sigurisë)

NVR	National Vehicle Register (Regjistri Nacional i Mjeteve Lëvizëse)
UIC	International Union of Railway (Unioni Nderkombëtar i Hekurudhave)
ECM	Entity in Charge of Maintenance (Entiteti Përgjegjës për Mirembajtje)
CSM	Common Safety Method (Metodat e Përbashkëta të Sigurisë)
EC	European Comision (Komisioni Evropian)
TAIEX	Technical Assistance and Information Exchange instrument (Asistenca Teknike dhe Shkëmbimi i Informacionit)
TCDD	Turkiye Cumhuriyeti Devlet Demiryollari (Hekurudhat Shtetërore të Turqisë)
STI	Specifikimet Teknike për Interoperabilitet (Technical Specification for Interoperability)
NVR	Nacional Vehicle Register (Regjistri Nacional i Mjeteve Levizese)
VKM	Vehicle Keeper Marking (Shenjëzimi i Mbajtesit të Mjetit Lëvizës)
CSI	Common Safety Indicator (Indikatorët e Përbashkëta të Sigurisë)
NSA	Nacional Safety Authority
KRPP	Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik
AQP	Agjensioni Qendror i Prokurimit
OSHP	Organi Shqyrtues i Prokurimit
NH	Ndërmarrje hekurudhore
MLJK	Mjetet lëvizëse jashtë Kosovës

■Përmbledhje ekzekutive

Ky është Raporti Vjetor i tetë me radhë që nxjerr menaxhmenti i ARH-së, si një rregullator i pavarur. Përmes këtij dokumenti prezantohet të arriturat e ARH brenda periudhës 1 janar – 31 dhjetor 2017, me qëllim që të ofrojmë një pasqyrë të zhvillimeve në këtë fushë. Ky raport përshkruan gjerësisht aktivitetet e ARH-se në hallkat kryesore të funksionimit të saj (Licencim, Siguri, Interoperabilitet dhe Rregullim të Tregut), përfshirë dhe sfidat përcjellëse përgjatë këtij viti.

Autoriteti Rregullativ i Hekurudhave (ARH) është organ i pavarur i themeluar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës, i ngarkuar me përgjegjësitë për rregullimin, mbikëqyrjen, organizimin e sektorit hekurudhor në Republikën e Kosovës. ARH ofron shërbime cilësore të sigurt, transparente dhe jo diskriminuese për ndërmarrjet hekurudhore dhe menaxherin e infrastrukturës në sektorin hekurudhor në Republikën e Kosovës dhe kompetencave të tjera të cilat i jepen në bazë të Ligjit Nr. 04/L-063 për Hekurudhat e Republikës së Kosovës i cili është në përputhje të plotë me legjislacionin dhe direktivat në fuqi të BE-së.

Raporti në tërësi ofron informacion mbi: bazën ligjore, përshkrimin dhe organizimin institucional, përshkrimin e fushës që mbulon ARH, punën gjatë vitit paraprak, raportin financiar, raportin rreth rekomandimeve të zyrës së Auditorit të Përgjithshëm si dhe shtojcat.

Duke qenë se ARH vepron si organ për: Licencim, Siguri, Interoperabilitet dhe Rregullim të Tregut, edhe përmbajtja e raportit elaboron me specifikisht progresin dhe arritjen e objektivave të saj kryesisht në këto fusha. Edhe gjatë vitit 2017 ARH ka vazhduar të ushtrojë funksionet e veta rregullatore në katër fusha kryesore:

Licencimi: Si organ përgjegjës për lëshimin e licencave për makinistët, ndërmarrjet hekurudhore si dhe amendamentimin, suspendimin dhe revokimin e këtyre, ka realizuar një sërë aktivitetesh me përkushtim dhe angazhim maksimal si: shqyrtimi i aplikacioneve të reja për licenca të makinistëve, shqyrtimi dhe përgjigja në kërkesat për licence për transport hekurudhor të mallrave, monitorimi i licencave të lëshuara, përfshirë inspektimet për makinistët e licencuar,

draftimi i Rregullores për Taksa dhe Gjoba dhe rregulloreve të tjera, hartimi i raporteve të veçanta për aktivitetet e lartcekura, përditësimi i regjistrit të licencave dhe aktivitete të tjera në përputhje me legjislacionin që e rregullon këtë fushë.

Siguria – Organi për sigurinë hekurudhore është krijuar nën mbikëqyrjen e ARH-së dhe është përgjegjës që siguria hekurudhore është mbajtur dhe përmirësuar pas rindërtimit të sistemit hekurudhor në Kosovë. Bazuar në këtë organ i sigurisë hekurudhore për vitin raportues ka realizuar aktivitetet si në vijim: ka përgatitur një pjesë të akteve nën ligjore për nevojat e funksionimit të organit të sigurisë si dhe ka draftuar dy rregullore tjera; ka përgatitur Raportin Vjetor të Sigurisë për vitin 2016; janë lëshuar autorizimet për futjen në shërbim të mjeteve lëvizëse hekurudhore (një Lokomotivë për ndërmarrjen private Railtrans si dhe dhjetë vagonë të udhëtarëve për ndërmarrjen shtetërore Trainkos). Janë inspektuar të gjitha linjat dhe mjetet lëvizëse në menaxhim të Infrakos-it si dhe janë inspektuar të gjitha mjetet lëvizëse në menaxhim të Trainkos-it, Railtrans-it dhe Ferronikel-it. Kemi përfunduar procesin e mbikëqyrjes së implementimit të Sistemit për Menaxhimin e Sigurisë (SMS) nga ana e operatorit me trena Trainkos, menaxherit të infrastrukturës Infrakos dhe operatorit privat Railtrans. Të gjitha këto inspektime dhe mbikëqyrje janë shoqëruar me nga një raport të detajuar mbi të gjeturat të cilat janë dërguar te kompanitë përkatëse ku në këtë raport janë futur si shtojca. Përpos tjerash organi i sigurisë hekurudhore ka përgatitur pothuajse të gjitha raportet Matricat të cilat kanë të bëjnë me implementimin e Planit Kombëtar të Zbatimit të Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit (PKZMSA), Inputin e II për Raportin e Këshillit të Evropës-së për Kosovën 2018, ka marrë pjesë pothuajse në të gjitha takimet e Nën-Komitetit të MSA-së për Energji, Transport, Mjedis dhe Zhvillim Rajonal të cilat janë organizuar nga Misioni i Integritetit Evropian apo institucionet tjera të linjës, etj.

Interoperabiliteti: Organ i pavarur, përgjegjës në Kosovë për të siguruar që sektori hekurudhor përputhet me kërkesat për interoperabilitet, siç janë definuar nga direktivat dhe rregulloret e BE-së, me qëllim që Kosova të jetë pjesë e zonës Evropiane të interoperabilitetit hekurudhor. Si rezultat i përgjegjësisë të lartë dhe angazhimit maksimal paraqesim arritjet në vazhdim të këtij raporti:

Gjatë vitit 2017 është realizuar regjistrimi i mjeteve të reja dhe regjistrimi i mjeteve të modifikuara aplikuar nga menaxheri i infrastrukturës dhe ndërmarrjet hekurudhore, inspektimi i regjistrimit të gjitha mjeteve lëvizëse hekurudhore të cilat janë të regjistruara që nga 2012 deri në fund të vitit 2017 përcjellë me raportet e inspektimeve NVR 2017. Gjithashtu është realizuar shënjimi i kodit të VKM-së në të gjitha mjetet lëvizëse hekurudhore të të gjithë operatoreve hekurudhore, azhurnimi i listës së marrëveshjeve ndërkombëtare dhe aktivitete të tjera paraqitur në pjesën e dedikuar për fushën e Interoperabilitetit. ARH në bashkëpunim me Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik (MZHE), Menaxherin e Infrastrukturës Hekurudhore INFRAKOS dhe Operatorin me Trena TRAINKOS, ka realizuar regjistrimin e të gjitha mjeteve lëvizëse hekurudhore (MLJK) që janë pronë e hekurudhave të Kosovës të cilat gjenden jashtë territorit të Republikës së Kosovës që nga pas lufta.

Megjithatë arritja e Interoperabilitetit në kuptimin e kompleksitetit të saj mbetet edhe me tej sfiduese për ARH-në. Ne jemi përqendruar në përpjekjet tona për krijimin e kushteve përmes së cilave mund të arrihet interoperabiliteti hekurudhore. Miratimi i STI për të gjitha nënsistemet hekurudhore mbetet sfidë që do ta përcjellë në vitet në vazhdim ARH-në.

Rregullimi i Tregut: Organ përgjegjës për të siguruar kushtet për hapjen e tregut hekurudhor në Kosovë, ka zhvilluar aktivitete të cilat vlerësohen në këtë fushë:

Mbikëqyrja e procesit të konsultimit për Ekspozeun e Rrjetit 2018 duke siguruar që Ekspozeu i Rrjetit të mos përmbajë klauzola diskriminuese jo transparente, shqyrtimi i ankesave të pranuar, sigurimi që qasja në binarë, stacione, depot e operatorëve që plotësojnë kushtet e domosdoshme të jetë e drejtë transparente dhe jo diskriminuese. Puna dhe angazhimi i rregullimit të tregut ka qenë e fokusuar në gatishmërinë e vazhdueshme që të merren masa kur është e nevojshme për të arritur këtë. Gjithashtu është bërë edhe monitorimi i tregut hekurudhor si dhe është përgatitur Raporti Vjetor i Monitorimit të Tregut 2016 dhe është dërguar në IRG-Rail. Rregullimi i Tregut ka bashkëpunuar me organet e tjera rregullative të tregut hekurudhor, veçmas sa i përket Marrëveshjes së Komunitetit të Transportit ndërmjet partnerëve të SEETO-së dhe IRG – Rail në mënyrë që të lehtësohen dhe koordinohen kushtet rregullative të tregut hekurudhor me vendet e tjera.

Në rrafshin normativ, në pajtim me planin e punës për vitin 2017, ARH-ja ka përgatitur akte nënligjore për zbatimin e Ligjit për Hekurudha, në përputhje me standardet e BE-së për fushën e hekurudhave.

Zyra Kombëtare e Auditimit (ZKA) gjatë muajit maj të vitit 2017 ka publikuar Raportin e Auditimit (nr. dokumenti 24.22.1-2016-06) për pasqyrat financiare të ARH-së për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2017. Zyra Kombëtare e Auditimit si konkluzione dhe rekomandime kryesore ka paraqit se duhet të sigurohet se procesi i përgatitjes së PFV (Pasqyrat Vjetore Financiare) 2017 dhe shpalosjeve përfshinë një rishikim menaxherial formal dhe efektiv, të zbatohet një proces rigoroz për të siguruar që procesi i vetëvlerësimit dhe menaxhimi i rrezikut adresohen në mënyrë efektive dhe reale dhe të sigurohet që aranzhimet e qeverisjes janë rishikuar në mënyrë kritike për t'u siguruar se janë bërë ndryshime adekuate në fushën e planifikimit strategjik.

Ndarjet Buxhetore fillestare të ARH-së për vitin 2017 ishin 303,823.00 €, mirëpo më vonë sipas nevojave tona potenciale ky buxhet ka pasur ndryshime (si transfere të brendshme dhe mbështetje financiare) ku si buxhet final kemi pasur 313,823.00 €.

Gjatë këtij viti ARH ka shpenzuar 291,300.25 që do të thotë se është realizuar 92.82 % raporti shpenzim-buxhet final.

Objektivat

ARH do të vazhdojë të jetë një rregullator aktiv dhe shumë i rëndësishëm në zhvillimin e sektorit të transportit hekurudhor në vend, duke siguruar vazhdimësinë e angazhimeve të ARH-së edhe për vitet e ardhshme. Jemi të bindur se në sajë të përpjekjeve tona të përbashkëta, për vitin e ardhshëm do të kemi rezultate shumë më të mira në sektorin e transportit hekurudhor në Republikën e Kosovës.

ARH edhe më tej vazhdon të këtë qëllim kryesor zhvillimin e një sistemi efikas dhe të sigurt të transportit hekurudhor, të integruar në rajon dhe në rrjetin e BE-së, që promovon zhvillimin ekonomik dhe cilësinë e jetës së qytetarëve.

■ Korniza ligjore

ARH është organ i pavarur që rregullon dhe mbikëqyrë sektorin e hekurudhave në përputhje me legjislacionin në fuqi në Kosovë dhe me legjislacionin në fuqi të BE-së, të përshtatshëm për Kosovën në këtë sektor.

Baza ekzistuese ligjore që rregullon ARH-në

- *Ligji për Hekurudhat e Kosovës Nr. 04/L-063*
- *Rregullore e Brendshme e ARH për Organizimin dhe Funksonimin e Brendshëm dhe Sistemimin e Vendeve të Punës*
- *Udhëzimi Administrativ Nr. 02/2012 për Licencimin e Ndërmarrjeve Hekurudhore*
- *Udhëzimi Administrativ Nr. 03/2012 për Licencimin e Menaxherëve të Infrastrukturës*
- *Udhëzimi Administrativ Nr. 04/2012 për Dhënien e Certifikatës dhe Autorizimit të Sigurisë për Ndërmarrjet Hekurudhore dhe Menaxherët e Infrastrukturës Hekurudhore*
- *Rregulloren Nr. 01/2012 për Licencimin e Menaxherëve dhe Ndërmarrjeve Hekurudhore*
- *Rregullore Nr. 03/2012 për Certifikatat e Sigurisë*
- *Rregullore Nr. 04/2012 për Autorizimin e Sigurisë*
- *Rregullore Nr. 05/ 2012 për Regjistrin Nacional të Mjeteve Lëvizëse Hekurudhore, dhe*
- *Rregullore Nr. 06/ 2012 për Regjistrimin e Infrastrukturës.*
- *Rregulloren Nr. 01/2013 për Ekspozeun e Rrjetit*
- *Rregulloren Nr. 02/2013 për Licencimin e Makinistëve.*
- *Rregullore Nr. 01/2014 për Modelin e Deklaratës së Konformitetit për Llojin e Autorizuar të Mjetit Hekurudhor.*

Përmirësimi i bazës ligjore në periudhën raportuese

Gjatë vitit 2017 ARH ka miratuar këto Rregullore:

- *Rregullore Nr. 01/2017, për Taksa dhe Gjobat;*
- *Rregullore Nr. 02/2017, për Raportimin e Monitorimit të Tregut Hekurudhor;*
- *Rregullore Nr. 03/2017 për Të Drejtat e Udhëtarëve;*
- *Rregullore Nr. 04/2017, për Metodën e Përbashkëta të Sigurisë për Vlerësimin e Konformitetit me kërkesat për marrjen e Autorizimit të Sigurisë hekurudhore;*
- *Rregullore Nr. 05/2017, Metodën e Përbashkëta të Sigurisë (MPS), për Vlerësim dhe Llogaritje të Rrezikut;*
- *Rregullore Nr. 06/2017 për Organizimin dhe Funkcionimin e Brendshëm të ARH-së;*
- *Plotësim ndryshimi i Udhëzimit Administrativ Nr. 02/2012 për Licencimin e Operatorëve Hekurudhor me Udhëzimin Administrativ Nr. 17/2017;*
- *Plotësim ndryshimi i Udhëzimit Administrativ Nr. 03/2012 për Licencimin e Menaxherit të Infrastrukturës me Udhëzimin Administrativ Nr. 18/2017;*

Vështirësitë ligjore që ka hasur ARH në përmbushjen e misionit të vet

ARH identifikon dhe raporton vështirësitë për të cilat vlerëson se ndikojnë në zbatimin efektiv të Ligjit të Hekurudhave. Gjatë zbatimit, kemi hasur në disa paqartësi rreth kompetencave ndërinstitucionale, me theks të posaçëm mes Autoritetit Rregullativ të Hekurudhave dhe Ministrisë së Infrastrukturës si dhe mos përputhshmërisë me disa nga Direktivat e Bashkimit Evropian në fushën e transportit hekurudhor.

ARH raporton se deri në këtë periudhë nuk ka pasur ndonjë ndryshim në legjislacion të hekurudhave i cili do të kishte ndikuar në rritjen apo zvogëlimin e efikasitetit të institucionit të ARH-së.

■ Përshkrimi i ARH-së

Autoriteti Rregullativ i Hekurudhave është themeluar në bazë të Ligjit Nr. 03/L-076 dhe ka filluar të funksionoj nga prilli i vitit 2010, ndërsa tani ARH funksionon sipas Ligjit Nr. 04/L-063 për Hekurudhat e Republikës së Kosovës. ARH është organ i pavarur që rregullon dhe mbikëqyrë sektorin e hekurudhave në përputhje me legjislacionin në fuqi në Kosovë dhe me legjislacionin në fuqi të BE-së, të përshtatshëm për Kosovën në këtë sektor. Ky ligj zbatohet për funksionimin, mirëmbajtjen dhe shfrytëzimin e Hekurudhave të Kosovës dhe infrastrukturës së saj, si dhe për të gjitha operimet e trenave që shfrytëzojnë këtë infrastrukturë

Misioni/Vizioni

MISIONI

Misioni i ARH-së është rregullimi, mbikëqyrja dhe organizimi i sektorit hekurudhor në Republikën e Kosovës në këto fusha: Licencim, Siguri, Interoperabilitet dhe Rregullim të Tregut dhe kompetencave të tjera të cilat i jepen në bazë të këtij ligji.

VIZIONI

Vizioni i ARH-së është që të ofroj shërbime cilësore dhe të sigurta transparente dhe jo diskriminuese për Ndërmarrjet Hekurudhore dhe Menaxherin e Infrastrukturës në sektorin hekurudhor në Republikën e Kosovës.

3.2. Kompetencat e ARH sipas Ligjit

Sipas Ligjit për Hekurudha, Autoriteti Rregullativ i Hekurudhave rregullon dhe mbikëqyrë këto fusha:

6. Licencim

Departament i pavarur përgjegjës për lëshimin e licencave për makinistët, ndërmarrjet hekurudhore si dhe amendamentimin, suspendimin dhe revokimin e këtyre

1. Siguri

Departament i pavarur përgjegjës për sigurinë hekurudhore, për të siguruar që siguria hekurudhore është mbajtur dhe përmirësuar pas rindërtimit të sistemit hekurudhor në Kosovë, gjithashtu përgjegjës për lëshimin, amendamentimin, suspendimin dhe revokimin e Autorizimit të Sigurisë dhe Certifikatës së Sigurisë.

2. Interoperabilitet

Departament i pavarur, përgjegjës në Kosovë për të siguruar që sektori hekurudhor përputhet me kërkesat për interoperabilitet siç janë definuar nga direktivat dhe rregulloret e BE-së, me qëllim që Kosova të jetë pjesë e zonës Evropiane të interoperabilitetit hekurudhor.

3. Rregullimi i Tregut

Departament i pavarur përgjegjës për të siguruar kushtet për hapjen e tregut hekurudhor në Kosovë.

■ Fushëveprimi institucional


Struktura organizative e ARH-së

Struktura e ARH-së, miratohet nga Bordi dhe përfshinë: Menaxhmentin, Departamentet dhe personelin mbështetës. Struktura organizative e ARH-së në bazë të Ligjit të Hekurudhave dhe Rregullores për Organizimin dhe Funksonimin e Brendshëm dhe Sistemimin e Vendeve të Punës, përbëhet nga:

- Bordi Mbikëqyrës;
- Drejtori i Përgjithshëm;
- Departamenti Ligjor/Licencim;
- Departamenti i Sigurisë;
- Departamenti i Interoperabilitetit;
- Departamenti i Rregullimit Tregut;
- Departamenti i Administratës;
 - Divizioni i Prokurimit
- Departamenti i Financave;

Në bazë të Rregullores për organizimin dhe funksionimin e brendshëm dhe sistemimin e vendeve të punës figurativisht është paraqitur struktura organizative e ARH-së

Skema organizative e ARH-së





Bordi mbikëqyrës i ARH-së

Veprimtaria e ARH-së mbikëqyret nga Bordi Mbikëqyrës, i zgjedhur nga Kuvendi i Republikës së Kosovës.

Bordi ARH-së përbëhet prej pesë (5) anëtarëve dhe njëri prej tyre zgjidhet Kryesues, anëtari i pestë i Bordit është Drejtori i Përgjithshëm i ARH-së.

Takimet e Bordit drejtohen në pajtim me procedurat e brendshme të miratuara nga Bordi dhe së paku një (1) herë në çdo muaj. Mbledhjet e Bordit nuk mund të zhvillohen nëse nuk ka kuorum. Vendimet e Bordit merren me shumicën e votave. Çdo anëtar i Bordit ka një (1) votë për çdo zgjidhje dhe kur numri i votave në favor të zgjidhjes është i barabartë me numrin e votave kundër, vota e kryesuesit është vendimtare.

i. Mandati

Kuvendi i emëron katër (4) anëtarë, njëri prej të cilëve emërohet kryesuesi i Bordit të cilët propozohen nga Qeveria me rekomandim të Ministrisë. Çdo anëtar i Bordit emërohet për një mandat pesë vjeçar (5), i cili mund të emërohet më së shumti edhe për një (1) mandat.

ii. Kompetencat

Bordi mbikëqyrës është përgjegjës për mbikëqyrjen dhe shqyrtimin e aktiviteteve dhe vendimeve të ARH-së mbi çështjet administrative, ekzekutive, rregullatore, sic janë: licencimi, siguria, interoperabiliteti si dhe rregullimi tregut dhe aspekteve të menaxhimit financiar, të hyrave dhe shpenzimeve të ARH-së. Bordi i ARH-së, miraton të gjitha aktet nënligjore të departamenteve të cilat janë në kuadër të sajë.

iii. Funksionalizimi

Bordi Mbikëqyrës i ARH-së është funksional në kryerjen e detyrave dhe përgjegjësi të tij. Bordi ka mbajtur 16 mbledhje të rregullta zyrtare dhe 1 mbledhje të jashtëzakonshme. Po ashtu, në kuadër të detyrave të veta ka realizuar edhe një sërë takimesh me akterë ndërkombëtarë e vendor në sektorin hekurudhor. Në rrafshin normativ ka miratuar plotësim ndryshimin e Rregullores për Organizimin dhe Funksionimin e Brendshëm të ARH-së dhe Rregulloren për të Hyra dhe Taksat, si dhe katër rregullore për fushat profesionale që mbulon ARH

Ekzekutivi

i. Drejtori i Përgjithshëm i ARH-së

Drejtori i Përgjithshëm është përgjegjës për menaxhimin dhe drejtimin e punëve të përditshme dhe në pajtim me politikat dhe udhëzimet e nxjerra nga Bordi. Drejtori i Përgjithshëm zgjedhet nga Bordi Mbikëqyrës në përputhje me legjislacionin në fuqi për Shërbimin Civil. Ai që nuk ka të drejtë të shërbejë në Bord nuk do të ketë të drejtë të emërohet as Drejtor i Përgjithshëm.

ii. Menaxhmenti i mesëm

Menaxhmenti i mesëm i ARH-së përbëhet nga Kryesuesit e Departamenteve dhe Menaxherët e zyrave, të cilët janë përgjegjës për veprimtarinë e tyre brenda fushëveprimit dhe kompetencave të tyre të përshkruara në përshkrimet e punës. Drejtori i Përgjithshëm i ngarkon strukturat udhëheqëse me kompetenca të përshkruara sipas Rregullores së Brendshme dhe mund t'ia delegojë kompetencat e tij apo kompetencat e ARH-së një strukture apo punonjësi jashtë fushëveprimit të detyrave të kësaj strukture, nëse ai e sheh të nevojshme.

iii. Mandati

Drejtori i Përgjithshëm, është me kontratë punësimi me kohë të caktuar.

Zyrtaret që përbëjnë strukturën të ARH-së mbajnë Akte Emërimi me kohë të pacaktuar, ndërsa lloji i emërimit është i karrierës.

Burimet njerëzore

i. Numri i punëtorëve

ARH-ja ka 15 punëtorë shërbyes civil të gjithë me Akte Emërimi të karrierës, pa përfshirë katër (4) anëtarët e Bordit të cilët nuk janë shërbyes civil.

ii. Nevojat për punëtorë të rinj

ARH ka nevojë për punëtorë të rinj shtesë, në mënyrë që të përmbush mandatin e vet ligjor.

iii. Numri i trajnimeve dhe nevojat për trajnim

Zyrtarët e ARH –së gjatë vitit 2017 kanë ndjekur trajnime dhe takime të financuara nga donatorët si dhe trajnime të financuara nga buxheti i ARH-së. ARH-ja investon në ngritjen profesionale dhe përditësimin e njohurive të specializuara të personelit të vet, në përputhje me standardet dhe praktikat e rekomanduara ndërkombëtare. Zyrtarët kane ndjekur trajnimet kryesisht në institucionet relevante të sektorit hekurudhor, në Institutin Kosovar për Administratë Publike (IKAP), Ministrinë e Administratës Publike, Ministrinë e Financave, etj.

Gjatë vitit 2017 janë realizuar gjithsejtë 17 takime, vizita dhe trajnime jashtë vendit ndjekur nga 15 zyrtarë brenda ARH-së

ARH, karshi zhvillimeve të reja, në vazhdimësi ka nevojë për ngritje të kapaciteteve profesionale duke ndjekur trajnimet e nevojshme në fushën e licencimit, sigurisë, interoperabilitetit, rregullimit të tregut si dhe në fushat tjera mbështetëse, si: administratë, financa dhe prokurim.

Trajnimet, vizitat studimore dhe punëtoritë kryesore janë paraqitur në formë tabelare si në vijim:

Tabela 1: Trajnimet kryesore gjatë vitit 2017

Nr	Trajnime/vizita zyrtare/vizita studimore	Organizatori
1	Eurasia Rail 2017 – Stamboll	Ministria e Transportit të Turqisë / Hekurudhat shtetërore turke
2	Takimi i 26 ^{të} Hekurudhor i Grupit Punues Intermodal i SEETO-s - Tiranë	SEETO
3	Vizitë Studimore për vendet e IPA-s - Helsinki	Agjencia Evropiane e Hekurudhave – ERA
4	Takimi i 1 ^{rë} Plenar i Asamblesë së Rregullatorëve të Pavarur Evropian (IRG – rail) – Paris	IRG - Rail
5	Takimi i 27 ^{të} Hekurudhor i Grupit Punues Intermodal i SEETO-s – Podgoricë	SEETO
6	Vizitë Studimore për aspektet e Sigurisë dhe Interoperabilitetit Hekurudhor - Budapest	Agjencia Evropiane e Hekurudhave – ERA, Ministria e Transportit e Hungarisë, Agjensioni i Sigurisë Hekurudhore Hungareze dhe Universiteti Teknik i Hungarisë
7	Trajnim Siguria dhe shëndeti në punë - Londër	Infrakos dhe EBRD (Occupational Health and Safety - Rail Sector – UK)
8	Takimi i 46 ^{të} Plenar i Autoriteteve Kombëtare të Sigurisë dhe vendeve të IPA-s - Valenciennes	Agjencia Evropiane e Hekurudhave - ERA
9	Trajnim për Inspektimin e Sigurisë Hekurudhore - Durrës	Drejtoria e Inspektoratit Hekurudhor të Shqipërisë
10	Aspekti teorik – praktik mbi Zhvillimin e Auditimit, Rishikimi i cilësisë dhe ndjekja e rekomandimeve të auditimit - Durrës	IKAP
11	Kontrolli i brendshëm administrativ dhe ligjor, menaxhimi i financave, pasurisë, auditit, raportimit financiar, ekzekutimi i buxhetit dhe prokurimi elektronik - Banskó	LMC&ITA
12	Takimi i 28 ^{të} Hekurudhor i Grupit Punues Intermodal i SEETO-s - Bar	SEETO
13	Takimi i 2 ^{të} Plenar i Asamblesë së Grupit të Rregullatorëve të Pavarur Hekurudhor (IRG - Rail) - Paris	IRG - Rail

3.1.1. Bashkëpunimi ndërinstitucional dhe aktivitetet e ARH-së në rrafshin vendor dhe ndërkombëtar

ARH ka bashkëpunuar ngushtë me institucionet tjera përgjegjëse vendore dhe ndërkombëtare për transportin hekurudhor në Republikën e Kosovës dhe ka ofruar përkrahje profesionale në mënyrë që i tërë sistemi rregullator dhe mbikëqyrës i shtetit të funksionojë i koordinuar dhe në përputhje me standardet dhe praktikat më të mira ndërkombëtare.

Eurasia Rail 2017 - Nën mbikëqyrjen e Ministrisë së Transporteve të Turqisë dhe Hekurudhave shtetërore turke TCDD, nga data 01.03.2017 – 03.03.2017 është organizuar Takimi i 7-të EURASIA RAIL 2017, ku pjesëmarrës në këtë takim ishin edhe përfaqësues nga ARH. Në këtë ngjarje të rëndësishme në të cilën paraqiten përparimet shkencore dhe teknologjike në sektorin hekurudhor, kanë marrë pjesë më shumë se 200 përfaqësues dhe kompani shtetesh nga 25 vende, si dhe rreth 11949 pjesëmarrës profesional nga e gjithë bota.



Fig.1 Eurasia Rail 2017

Takimi i 26^{të} Hekurudhor i Grupit Punues Intermodal i SEETO-s - Me datë 02 - 03



Fig.2: Takim i 26^{të} Hekurudhor i Grupit Punues Intermodal i SEETO-s

mars 2017, në Tiranë është mbajtur Takimi i 26^{të} Hekurudhor i Grupit Punues Intermodal i SEETO-s. Qëllimi i këtij takimi ka qenë diskutimi i strategjisë për krijimin e një zone të vetme evropiane hekurudhore, për të zhvilluar dhe avancuar sektorin hekurudhor në vendet e Evropës Juglindore, përfshirë Republikën e Kosovës. Në këtë takim ndërkombëtar prezent ishin edhe përfaqësues nga ARH-ja, ku kanë shfrytëzuar mundësinë që përpos temave të parapara në agjendën e takimit, në të njëjtën kohë kanë realizuar edhe takime tjera me të pranishmit, siç ishin zyrtarët nga Komisioni Evropian, si dhe përfaqësues

të sektorit hekurudhor nga vendet fqinje, pjesëmarrës në këtë takim për të diskutuar çështje në të mirë të sektorit hekurudhor në Kosovë.

Vizitë Studimore për vendet e IPA-s

Nën organizimin dhe sponsorizimin e Agjencionit Evropian të Hekurudhave (ERA), në Helsinki të Finlandës, me datë 09 – 11 Maj 2017 janë mbajtur disa aktivitete të rëndësishme për sektorin hekurudhor ku në mesin e shumë vendeve pjesëmarrëse ishte edhe Kosova, përfaqësuar me një delegacion nga



Fig.3: Vizitë studimore për vendet e IPA-s

Autoriteti Rregullativ i Hekurudhave. Gjatë këtyre ditëve të qëndrimit në Helsinki, delegacioni i ARH-së ka marrë pjesë në trajnimet e kombinuar në shtjellimin e temave për shkollimin dhe trajnimin në punë praktike të makinistëve të trenave si dhe plotësimin e kërkesave nga aspekti i mirëmbajtjes së mjeteve lëvizëse në punëtoritë e mirëmbajtjes në Helsinki. Gjithashtu pjesëmarrësit kanë vizituar Kolegjin Hekurudhor të Finlandës (Finnish Railway College) në Kouvola, në të cilin shkollohet dhe përgatitet stafi i cili do të punoi në Hekurudhat e Finlandës, janë ndjekur disa prezantime në Qendrën e Mirëmbajtjes së Mjeteve Lëvizëse Hekurudhore në Helsinki si dhe kanë shfrytëzuar rastin dhe mundësinë që të shohin për së afërmi llojet e mirëmbajtjeve të cilat kryhen në këtë qendër, e cila është qendra kryesore e mirëmbajtjes së mjeteve lëvizëse në Finlandë.

Takimi i 1^{re} Plenar i Asamblesë së Rregullatorëve të Pavarur Evropian (IRG – Rail) - Përfaqësues nga ARH kanë marrë pjesë në Takimin Plenar të Asamblesë së Rregullatorëve të Pavarur Evropian (IRG – Rail), i mbajtur në Paris – Francë me datë 12.05.2017. Në këtë takim plenar është miratuar Dokumenti Strategjik 2017 – 2020 për sektorin hekurudhor, ku pjesë e këtij takimi ka qenë edhe prezantimi i Raportit të pestë të Monitorimit të Tregut në sektorin hekurudhor.



Fig.4: Takim 1^{re} Plenar i Asamblesë së Rregullatorëve të Pavarur Evropian (IRG Rail)

Vizitë Studimore për aspektet e Sigurisë dhe Interoperabilitetit Hekurudhor - ARH është përfaqësuar në vizitën studimore të organizuar dhe sponsorizuar nga Agjencioni i Bashkimit Evropian për Hekurudha, Ministria e Transportit të Hungarisë, Agjencioni i Sigurisë Hekurudhore dhe Universiteti Teknik i Hungarisë, ku pjesëmarrës ishin të gjitha vendet e Bashkimit Evropian, vendet e IPA-s (Kosova, Shqipëria, Maqedonia, Mali i Zi, Bosnja dhe



Fig.5: Vizitë Studimore për aspektet e Sigurisë dhe Interoperabilitetit Hekurudhor

Hercegovina, Serbia dhe Turqia) si dhe përfaqësues nga Izraeli. Temë diskutimi në këtë vizitë ishin aspektet e Sigurisë Hekurudhore dhe Interoperabilitetit, implementimi i legjislacionit Evropian, aplikimi i Metodave të Përbashkëta të Sigurisë për Vlerësimin dhe Llogaritjen e Rrezikut (Common Safety Method for Risk Evaluation and Assessment), aplikimi i ERTMS (European Railway Traffic Management System), i cili në vete përfshinë ETCS dhe GSM-R, ku u shtjelluan të gjitha nivelet e aplikimit të ETCS (European Train Control System).

Takimi i 28^{të} Hekurudhor i Grupit Punues Intermodal i SEETO-s - Një delegacion i ARH-së, morën pjesë në Takimin e 28^{të} Hekurudhor të Grupit Punues Intermodal i SEETO-s, i cili është mbajtur nga 09 – 11 Tetor 2017, në Podgoricë të Malit të Zi. Qëllimi i këtij takimi ka qenë formulimi i strategjisë për krijimin e një zone të vetme evropiane hekurudhore sipas ligjeve dhe direktivave të BE-së, analizimi i nevojave për trajnim në fushën e rregullimit të tregut si dhe ekonomia hekurudhore.

Në këtë aktivitet ndërkombëtar, ku të pranishëm ishin shumë përfaqësues nga sektori hekurudhor i vendeve fqinje dhe vendeve të BE-së, përveç temave të parapara sipas agjendës, pjesëmarrësit nga ARH kishin mundësinë që për së afërmi të njiheshin edhe me përvojat më të mira nga përfaqësuesit e sektorit hekurudhor të vendeve të rajonit dhe institucioneve hekurudhore të BE-së.



Fig.6: Takimi i 28^{të} Hekurudhor i Grupit Punues Intermodal i SEETO-s

Pjesëmarrja e zyrtarëve të ARH-së në këtë aktivitet ishte një mundësi e mirë që përveç temave me rëndësi që janë trajtuar, të shfrytëzojnë rastin për të realizuar takime tjera me të pranishmit, siç ishin përfaqësues të sektorit hekurudhor nga vendet fqinje dhe nga vendet e BE-së, për të diskutuar çështje me rëndësi dhe në të mirë të sektorit hekurudhor në Kosovë.

Takimi i 46^{të} Plenar i Autoriteteve Kombëtare të Sigurisë dhe vendeve të IPA-s - Delegacioni i ARH-së mori pjesë në takimin e 46^{të} Plenar të Autoriteteve Kombëtare të Sigurisë dhe vendeve të IPA-s, i cili u mbajt me datë 21 - 22 nëntor 2017, nën organizimin e Agjencionit Evropian të Hekurudhave (ERA). Tema e këtij takimi ishte harmonizimi i rregullave kombëtare me kërkesat e BE-së.



Fig.7: Takimi i 46^{të} Plenar i Autoriteteve Kombëtare të Sigurisë dhe vendeve të IPA-s

Në këtë aktivitet të organizuar nga ERA, ku pjesëmarrës ishin përfaqësues nga të gjitha vendet anëtare të Bashkimit Evropian dhe nga vendet e IPA-s, u trajtuan shumë tema me rëndësi për sektorin hekurudhor siç janë: kultura e sigurisë dhe roli i agjencioneve nacionale të sigurisë, programet e auditimit të cilat janë realizuar nën mbikëqytjen e ERA-s, ku këto programe kanë në fokus të veçantë ngritjen e kapaciteteve të organeve nacionale të sigurisë. Gjithashtu u diskutua edhe për pakon e katërt hekurudhore, si dhe për One Stop Shop, që ka të bëjë me dhënien e certifikatës unike të sigurisë në nivel Evropian.

Takimi i 46^{të} Plenar i Autoriteteve Kombëtare të Sigurisë dhe vendeve të IPA-s u përmbyll me diskutimin rreth perspektivës së projektit të IPA II (2018 -2019), ku u dhanë pikëpamjet e disa prej pjesëmarrësve lidhur me këtë projekt.

Takimi i 2^{të} Plenar i Asamblesë së Grupit të Rregullatorëve të Pavarur Hekurudhor (IRG - Rail) - Përfaqësues të Autoritetit Rregullativ të Hekurudhave kanë marrë pjesë në



Fig.8: Takimi i 2^{të} Plenar i Asamblesë së Grupit të Rregullatorëve të Pavarur Hekurudhor (IRG - Rail)

takimin e 2^{të} Plenar të Asamblesë së Grupit të Rregullatorëve të Pavarur (IRG - rail), ku ARH është anëtare me të drejta të plota.

Takim është mbajtur në Paris – Francë me datë 22 - 25 nëntor 2017, ku si fokus ka pasur çështje të ndryshme, siç janë: Votimi i pranimit të kandidaturës nga ana e Republikës së Çekisë në këtë organizëm evropian të hekurudhave; propozimi i strategjisë dhe grupit punues për

qasje në shërbime speciale hekurudhore, votimi i zv. Presidentit të IRG-së për vitin 2018, prezantimi i punës nga grupet punuese për pagesa në infrastrukturë, monitorim të tregut hekurudhor, vlerësimi i punës për vitin 2017 si dhe diskutimi i agjendës punuese për vitin 2018 të IRG-së.

Asetet

i. Asetet në posedim të institucionit

ARH-ja ka ne përdorim 294 asete me vlerë në blerje prej 108.955.48 €. Këto asete janë kryesisht orendi zyresh dhe pajisje teknologjike. Zhvlerësimi i aseteve bëhet çdo fund vit sipas dispozitave të Rregullorës MF-NR 02/2013 për Menaxhimin e Pasurisë jo Financiare në Organizatat Buxhetore dhe sipas Udhëzimit nr 01/2012 për Menaxhimin e Pasurisë së ARH-së. Sipas raportit të komisionit të inventarizimit dhe vlerësimit vlera e aseteve në ARH për vitin 2017 sipas rregullave të parapara me rregullorën e lartcekur është 20.608.81 €.

ii. Planet për asete të reja

ARH, për nevojat e funksionalizimit, planifikon (varësisht nga mundësitë buxhetore) që të siguroi objekt të përhershëm për zyre. Pasi tani, përveç që objekti që kemi në shfrytëzim nuk i plotëson kërkesat minimale të sipërfaqes për numrin e të punësuarve dhe fushë veprimtarin e vet, është edhe ngarkesë buxhetore qiraja që paguhet.

Investim tjetër i nevojshëm është edhe furnizimi me pajisje të teknologjisë informative, me inventar për zyre dhe mjete tjera për nevoja të ARH-së, etj.

Zyrat e ARH-së janë në Prishtinë në Rr. “Rrustem Statovci. nr. 29. Hapësira fizike e institucionit të ARH-së është 250 m². ARH-ja në vazhdimësi bënë kërkesë në Ministrinë e Administratës Publike për t’iu siguruar një objekt qeveritar, meqë objekti i tanishëm është pronë private dhe paguhet me qira nga ARH-ja.

Pagat e personelit të ARH-së

ARH ka prioritet mbikëqyrjen dhe sigurinë e sektorit hekurudhor. ARH-ja siguron që operimet hekurudhore në Republikën e Kosovës të realizohen në përputhje me Ligjin e Hekurudhave dhe standardet e BE-së. Për ta arritur këtë, rregullatori i hekurudhave të Kosovës ka nevojë për personel shumë të kualifikuar dhe me përvojë për t’i hartuar

standardet, procedurat, rregulloret dhe për të siguruar zbatimin e tyre nga operatorët përmes mbikëqyrjes së vazhdueshme dhe inspektimeve. Përkundër kësaj niveli i pagave të personelit të ARH-së që nga themelimi vazhdon që të jetë mjaft i ulët në krahasim me pagat e personelit të industrisë së hekurudhave dhe rregullatorëve tjerë të pavarur. Personeli i ARH nuk gëzon asnjë kompensim shtesë përveç pagës bazë nga buxheti i konsoliduar i Republikës së Kosovës. Si rezultat ARH rrezikon humbjen e stafit profesional aq më tepër në këtë kohë kur investimet janë drejtuar seriozisht në këtë sektor.

■ Aktivitetet për periudhën raportuese

i. Përshkrim i shkurtër i fushës që mbulon ARH dhe një krahasim me tri vitet e fundit


ARH është organ i pavarur që rregullon dhe mbikëqyrë sektorin e hekurudhave në përputhje me legjislacionin në fuqi në Kosovë dhe me legjislacionin në fuqi të BE-së, të përshtatshëm për Kosovën në këtë sektor.

ARH është organ i pavarur i themeluar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës i cili është i ngarkuar për rregullimin, mbikëqyrjen, organizimin e sektorit hekurudhor në Republikën e Kosovës dhe vepron si organ për: Licencim, Siguri, Interoperabilitet dhe Rregullim të Tregut. ARH ofron shërbime cilësore të sigurta, transparente dhe jo diskriminuese për ndërmarrjet hekurudhore dhe menaxherin e infrastrukturës në sektorin hekurudhor në Republikën e Kosovës dhe kompetencave të tjera të cilat i jepen në bazë të Ligjit Nr. 04/L-063 për Hekurudhat e Republikës së Kosovës i cili është në përputhje të plotë me legjislacionin dhe direktivat në fuqi të BE-së.


Krahasuar me vitet paraprake, duhet theksuar se ARH ka filluar të gjeneron të hyra nga aplikimet e ndërmarrjeve hekurudhore për shërbimet të cilat ARH i ofron bazuar në Rregulloren për të Hyra dhe Taksat. Ndërsa, nga aspekti i angazhimeve në pasurimin e infrastrukturës ligjore, ARH ka miratuar disa rregullore të nevojshme, të cilat i kemi listuar te pika 2.2. e këtij raporti

Në vijim për secilin aktivitet është bërë një përshkrim i shkurtër dhe një krahasim me tri vitet e fundit (2015,2016 dhe 2017)


Licencimi i makinistëve: Paraqitja në formë grafikoni e licencave për makinistë për vitin 2015, 2016 dhe 2017




Autorizimet për futje në shërbim: Të dhënat për autorizimet për futje në shërbim për mjetet lëvizëse hekurudhore për vitin 2015,2016 dhe 2017




Regjistrimi i mjeteve lëvizëse: Përmes grafikorit janë paraqitur numri i regjistrimeve, realizuar në vitin 2015, 2016 dhe 2017




Aksidentet hekurudhore: Paraqitja e të dhënave për aksidentet hekurudhore gjatë vitit 2015, 2016 dhe 2017



Personat e lënduar dhe të vdekur në aksidentet hekurudhore: Paraqitja e të dhënave për personat e lënduar dhe të vdekur gjatë vitit 2015, 2016 dhe 2017



Transporti mallrave dhe udhëtarëve: Në formë grafikoni janë paraqitur të dhënat për numrin e udhëtarëve për vitin 2015, 2016 dhe 2017, si dhe neto ton mallrat e transportuar gjate tri viteve të fundit (2015, 2016 dhe 2017)



Planifikimi dhe realizimi i punës 2017

Plani i Punës shërben për koordinimin e aktiviteteve të ARH-së dhe departamenteve përkatëse të tij, në mënyrë që të mundësohet përmbushja efikase dhe me kohë e synimeve dhe objektivave të përcaktuara. Plani i punës hartohet në atë formë duke i identifikuar objektivat e nevojshme vjetore për përmbushjen e obligimeve ligjore, të cilat hartohen në nivel të menaxhmentit. Prioritetet dhe synimet operative të përcaktuara me këtë plan janë në konsistencë me misionin dhe përgjegjësitë e ARH-së të përcaktuara me Ligjin e Hekurudhave të Kosovës. Realizimi i Planit Vjetor të punës rishikohet nga menaxhmenti i ARH-së.

Plani i punës për vitin 2017 dhe realizimi i tij është paraqitur në formë tabelare.

Tabela 2: Planifikimi i punës 2017 dhe realizimi

Realizimi i Planit të Punës për vitin 2017							
Aktivitetet e planifikuara		Periudha				Status i	Përfunduar Në Proces Pa Përfunduar
		K I	K II	K III	K IV		
1	Përgatitja dhe hartimi i Akteve nënligjore të nevojshme të ARH-së sipas ligjit të hekurudhave në pajtim me parimet e Direktivës të BE-së	x	x	x	x	E realizuar	
2	Regjistrimet e mjeteve lëvizëse	x	x	x	x	E realizuar	
3	Krijimi i regjistrit të mjeteve lëvizëse hekurudhore të Hekurudhave të Kosovës të cilat gjenden jashtë territorit të Kosovës	x	x			E realizuar	
4	Specifikacionet Teknike për Interoperabilitet për nënsistemin e Infrastrukturës dhe nënsistemin „Operimi dhe Menaxhimi i Trafikut,“					Në proces	
5	Përgatitja e pasqyrave financiare vjetore në bazë të LMFP-së	x				E realizuar	
6	Shqyrtimi i aplikacioneve për licenca të makinistëve dhe aplikacioneve për Licencë për operime për kompani ekzistuese dhe te reja	x	x	x	x	E realizuar	
7	Inspektimi i makinistëve të licencuar dhe përgatitja e raporteve të inspektimit të makinistëve	x	x	x	x	E realizuar	
8	Rregullat Nacionale të Sigurisë	x	x	x	x	E pa përfunduar (Agjencioni Evropian i Hekurudhave ka	

						marrë për sipër që në bashkëpunim me vendet e IPA-s të përgatis Rregullat Nacionale të Sigurisë)
9	Shqyrtimi i aplikacioneve për autorizime për futje në shërbim të mjeteve lëvizëse	x	x			E realizuar
10	Mbikëqyrja e implementimit të rekomandimeve nga inspektimi i mjeteve lëvizëse dhe infrastruktura hekurudhore gjatë vitit 2016	x	x	x	x	E realizuar
11	Shqyrtimin e ankesave për tregun hekurudhor në transportin e mallrave si dhe për të drejtat e udhëtareve			x	x	E realizuar
12	Monitorimi i marrëveshjes për kompensimin e "Obligimeve të Shërbimeve Publike"	x	x	x	x	E realizuar
13	Monitorimi dhe kontrollimi i "Marrëveshjes mbi qasjen" në mes të Sh.a.Infrakos, dhe Sh.a. Trainkos	x	x	x	x	E realizuar
14	Bashkëpunimi dhe koordinimi i të gjitha marrëveshjeve të nënshkruara me rregullator vendor dhe ndërkombëtar e në veçanti me IRG-Rail të Evropës	x	x	x	x	E realizuar
15	Përgatitja e Barazimeve vjetore si dhe Përgatitja dhe dorëzimi i Qarkores Buxhetore	x	x	x	x	E realizuar
16	Realizimi i Planifikimit të Prokurimit sipas nevojave të ARH-së	x	x	x	x	E realizuar
17	Azhurnimi i Regjistrit të Makinistëve të Licencuar	x	x	x	x	E realizuar
18	Mbikëqyrja e performancës së sigurisë për MI dhe NH	x	x	x	x	E realizuar
19	Mbikëqyrja e implementimit të SMS- Sistemit për Menaxhimin e Sigurisë-Infrakos-Trainkos	x	x	x	x	E realizuar
20	Përgatitja e dokumentit,, Libri i rregullave për	x	x	x	x	E realizuar

	makinistë,,					
21	Monitorimin e tregut hekurudhor në Kosovë, dhe përgatitjen e raportit të monitorimit të tregut Hekurudhor	x	x	x	x	E realizuar
22	Sigurimin se pagesat e vendosura nga Menaxheri i Infrastrukturës janë transparente dhe jo diskriminuese	x	x	x	x	E realizuar
23	Përgatitja e raportit vjetor të sigurisë			x	x	E realizuar
24	Pranimi dhe shqyrtimi i kërkesave për Qasje në Dokumente Publike, si dhe raportimi në ZKM sipas periudhave të parapara ligjore.	x	x	x	x	E realizuar

Veprimet e ARH-së për përmirësimin/monitorimin e fushës së veprimit

- | Monitorimi i Tregut Hekurudhor;
- | Avancimi në aspektet e sigurisë hekurudhore, përmes inspektimeve dhe dhënies së rekomandimeve;
- | Plotësimi i kuadrit ligjor me aktet nënligjore për përafrim me Direktivat Europiane
- | Shqyrtimi i aplikacioneve të reja për Licencim të makinistëve, si dhe monitorimi i atyre ekzistuese;
- | Dhënia e Autorizimeve për futjen në shërbim të mjeteve lëvizëse (lokomotiva dhe vagonëve të udhëtarëve) për NH

Sfidat e vitit raportues dhe planifikimi për vitin vijues

- | Përgatitja dhe implementimi i Specifikacioneve Teknike për Interoperabilitet;
- | Mbikqyrja e procesit të përgatitjes profesionale të makinistëve;
- | Plotësimi i kuadrit ligjor me aktet nënligjore nga ana e ARH-së dhe MI-së, në harmoni me legjislacionin e BE-së;
- | Plotësim/ndryshimi i Ligjit të Hekurudhave të Kosovës dhe adaptimi me nevojat dhe kërkesat praktike;
- | Përgatitja e Rregullave Nacionale të Sigurisë

■ Puna specifike e ARH gjatë vitit raportues

Aktivitetet dhe të arriturat kryesore të ARH-së gjatë vitit 2017 janë:

Fusha Licencimit

ARH, duke u bazuar në Ligjin për Hekurudhat e Kosovës, akteve nënligjore në fuqi, si dhe planin vjetor të punës; ka qenë i angazhuar kryesisht në: shqyrtimin e aplikacioneve të reja për licenca, përfshi ato të pranuar nga ndërmarrje hekurudhore për transport të udhëtarëve, mallrave apo të kombinuar, menaxhim të infrastrukturës hekurudhore si dhe licencim të makinistëve. Po ashtu, pjesë e aktiviteteve të ARH-së në këtë fushë ka qenë edhe monitorimi i licencave të lëshuara në vitet e kaluara për tri kategoritë e lartshënuara.

i. Licencimi i makinistëve

Vlen të theksohet se gjatë vitit 2017, ARH-ja ka pranuar aplikacione të reja vetëm për makinist, nga dy ndërmarrjet hekurudhore aktive brenda territorit të Republikës së Kosovës, Trainkos dhe Railtrans. Gjatë vitit raportues janë pranuar gjithsej tri aplikacione për licenca të makinistëve, ku ARH brenda afateve të parapara ligjore ka bërë shqyrtimin dhe vendosjen e tyre. Gjatë shqyrtimit, përveç respektimit të procedurave ligjore të parapara, shqyrtimi i këtyre aplikacioneve nga ana e ARH-së është bërë konform procedurave dhe kërkesave ligjore në fuqi, të parapara me Ligjin për Hekurudhat e Kosovës si dhe Rregulloren për Licencimin e Makinistëve Nr. 02/2013. Gjatë shqyrtimit të aplikacioneve jemi fokusuar në kushtet të cilat Ligji dhe Rregullorja i obligon që një makinist t'i përmbushë, në mënyrë që të marrë licencë. Këto kushte kanë qenë: Certifikata e Makinistit e lëshuar nga vetë ndërmarrja hekurudhore, ekzaminimi mjekësor konformë

kërkesave të parapara në ligj dhe Rregulloren për Licencimin e Makinistëve si dhe kualifikimi shkollor, që nënkupton përfundimin e shkollës së mesme.

ii. Licencë për transport të udhëtareve apo mallrave

Ndërsa sa i përket aplikimeve për licencë për transport të udhëtareve apo mallrave nuk ka pasur ndonjë aplikacion, as nga kompanitë vendore apo ato ndërkombëtare. Bazuar në Ligjin për Hekurudhat e Kosovës, tregu hekurudhor është i liberalizuar dhe se kompani të ndryshme të jashtme mund të aplikojnë për licencë të re apo njohje të saj. Vlenë të theksohet se në vitet paraprake, ka pasur interesim nga kompani të huaja, të cilat janë interesuar për procedurat e njohjes së licencës evropiane për transport hekurudhor të mallrave. Duke ju përgjigjur këtyre kërkesave për interesim, ne si ARH i kemi informuar rreth kriterëve, procedurave si dhe afateve ligjore, që duhet të plotësohet nga një ndërmarrje e caktuar në mënyrë që të pajisen me licencë.

iii. Njohja e licencës evropiane

Meqenëse tek njohja e licencës evropiane ka qene një paqartësi ligjore rreth kushteve dhe kriterëve për njohjen e kësaj licence, ARH këtë çështje e ka ngritur dhe adresuar tek Ministria e Infrastrukturës, së bashku me rekomandime konkrete. Kjo për faktin se Neni 10 i Ligjit të Hekurudhave ka përcaktuar në mënyrë të përgjithshme se licenca evropiane mund të njihet në Kosovë, mirëpo pa përcaktuar kushte dhe kriteret për një gjë të tillë. Si rezultat, Ministria e Infrastrukturës ka amandamentuar Udhëzimin Administrative Nr. 02/2012 me Udhëzimin Administrativ Nr. 17/2017, ku mes tjerash ka plotësuar në mënyrë specifike të gjitha procedurat dhe kriteret për njohje të licencës evropiane. Në grupin punues për plotësim ndryshimin e këtij Udhëzimi Administrativ ka qenë edhe ARH-ja, kështu duke dhënë kontributin e vet profesional, përkitazi me këtë çështje.

iv. Inspektimi i makinistëve

Në agjendën e monitorimit të licencave të makinistëve, ARH sipas vlerësimeve dhe nevojave, bënë inspektime të paparalajmëruara në terren për makinistët të cilët drejtojnë trenat brenda territorit të Republikës së Kosovës. Qëllimi i këtyre inspektimeve është

verifikimi, nëse trenat në Kosovë drejtohen nga makinistët e licencuar. Vlenë të theksohet, se që nga licencimi i parë i makinistëve i bërë nga ARH-ja në vitin 2015, nga të gjitha inspektimet në terren ka rezultuar se trenat drejtohen vetëm nga makinist të licencuar. Po ashtu, në kuadër të monitorimit të makinistëve të licencuar hyjnë edhe raportet mjekësore periodike nga institucionet shëndetësore kompetente të cilat i kërkon ARH-ja. Bazuar në legjislacionin pozitiv në Kosovë, makinistët mbi moshën 55 vjeçare, këto raporte mjekësore duhet t'i sjellin në baza të rregullta vjetore, kurse makinistët nën moshën e lartcekur, një herë në tre vite.

Duke ju përgjigjur kërkesave ligjore në fuqi, ne si ARH kemi krijuar dhe azhurnuar rregullisht regjistrin e makinistëve të licencuar në Republikën e Kosovës.

E njëjta kërkesë ligjore vlenë edhe për licencat e lëshuara për menaxher të infrastrukturës dhe ndërmarrjet hekurudhore, me kushtin shtesë që ky regjistër të jetë publik në ueb faqen e ARH-së. ARH ka krijuar dhe azhurnuar regjistrin e ndërmarrjeve hekurudhore dhe menaxherëve të infrastrukturës të licencuara në Republikën e Kosovës, sipas nevojës. Qëllimi i këtij regjistri është që çdo person fizik apo juridik, i cili ka nevojë dhe interes të ketë informacione për sektorin hekurudhor në Kosovë, një gjë të tillë mund ta bëjë në mënyrë shumë të lehtë dhe praktike në ueb faqen e ARH-së. Ne si ARH, kujdesemi që në këtë regjistër të mos ketë informacione të natyrës konfidenciale, e që do mund të dëmtonte ndërmarrjet e licencuara.

v. Monitorimi i licencave

ARH-ja, përveç licencave të makinistëve, bënë edhe monitorimin e licencave të lëshuara për menaxher të infrastrukturës dhe ndërmarrjeve hekurudhore. Ky monitorim është i përvitshëm dhe se kryesisht fokusohet në plotësimin e kushteve mbi bazën e të cilave është marrë licenca, konkretisht ripërtëritjes së policës së sigurimit për palët e treta, pasi që e njëjta ka afat të vlefshmërisë një vjeçare. Ngjashëm sikurse në vitet paraprake, ne si ARH edhe gjatë vitit 2017 kemi kërkuar në vazhdimësi që ky kusht të plotësohet pa ndërprerje, duke ju rikujtuar kohë pas kohe këtë detyrim ligjorë ndërmarrjeve hekurudhore dhe menaxherit të infrastrukturës, përkundër faktit se një gjë e tillë është në përgjegjësinë direkt të tyre. Qëllimi bazë i sigurimit është që në rast të aksidenteve apo incidenteve,

ndërmarrjet hekurudhore dhe menaxheri i infrastrukturës të jenë të mbuluara me sigurim adekuat.

Tabela 6.2: Regjistri i Licencave

Nr	Emri dhe adresa e kompanisë	Nr. i Licencës	Data e dhënies	Llojet e shërbimeve	Territori	Afati i Licencës prej:	Vërejtje
1	TRAINKOS sh. a. Sheshi i Lirisë p. n 12 000 Fushë Kosovë	KS 01/2012 0001	15.11.2012	Operimi me Trena	Republika e Kosovës	15.11.2012	
2	IINFRAKOS sh. a. Sheshi i Lirisë p. n 12 000 Fushë Kosovë	KS 02/2012 0001	15.11.2012	Menaxher i Infrastrukturës	Republika e Kosovës	15.11.2012	
3	Railtrans LLC Dardania BL9 LB4 p.n 10 000 Prishtinë	KS 01/2014 0001	10.03.2014	Operimi me Trena për Transport Hekurudhor të Mallrave	Republika e Kosovës	11.12.2015	

vi. Azhurnimi i Regjistrit Qendror të Lejeve

Një aktivitet tjetër me rëndësi për ARH-në në vitin raportues ka qenë koordinimi me Zyrën Ligjore të Kryeministrit, procesi i azhurnimit të Regjistrit Qendror të Lejeve dhe Licencave. Në kuadër të këtyre angazhimeve jemi koordinuar për plotësim/ndryshimin e formularëve në vijim:

Formulari së bashku me kriteret dhe procedurat ligjore për Licencë për Ndërmarrje Hekurudhore;

Formulari së bashku me kriteret dhe procedurat ligjore për Licencë për Menaxher të Infrastrukturës; si dhe

Formulari së bashku me kriteret dhe procedurat ligjore për Licencë të Makinistit.

Pas disa takimeve dhe sqarimeve me Zyrën Ligjore të Kryeministrit, është arritur finalizimi i këtij procesi. Tanimë në këtë regjistër qendror janë të gjitha të dhënat e sakta, ku përfshihen kriteret, procedurat, baza ligjore, dokumentacioni i nevojshëm si dhe afatet ligjore, për të gjithë të interesuar, qoftë brenda territorit të Republikës së Kosovës qoftë

jashtë, qoftë cilët shprehin interesim për të aplikuar për njëren nga licencat e transporti hekurudhor.

Fusha e Sigurisë

i. Përgatitja e legjislacionit sekondar (akteve nënligjore)

Aktivitet tjetër më rëndësi në të cilin kemi punuar shumë gjatë vitit 2017 ka qenë edhe përafrimi i legjislacionit sekondar (akte nënligjore) të Republikës së Kosovës me atë të Bashkimit Evropian. Gjatë kësaj kohe ne duke u bazuar në prioritetet tona ne kemi arritur të përgatim katër draft rregullore për të cilat kemi menduar se janë të rëndësishme për funksionimin e sektorit hekurudhor në Kosovë. Dy nga katër draft rregulloret e përgatitura janë aprovuar nga Bordi Mbikëqyrës i ARH në muajin dhjetor, kurse dy të tjerat presim që të miratohen në pjesën e parë të vitit 2018.

Rregulloret e miratuara nga Bordi Mbikëqyrës i ARH-së janë:

- 1. Rregullore Nr. 04/2017, për Metodën e Përbashkëta të Sigurisë për Vlerësimin e Konformitetit me kërkesat për marrjen e Autorizimit të Sigurisë hekurudhore; si dhe*
- 2. Rregullore Nr. 05/2017, Metodën e Përbashkëta të Sigurisë (MPS), për Vlerësim dhe Llogaritje të Rrezikut.*

Draft rregulloret e përgatitura e që pritet të miratohen nga Bordi Mbikëqyrës i ARH-së janë:

- 1. Rregullore Nr. xx/2017 Rregullore për Ndërtim, Përmirësim, Rinovim, Vlerësim të Konformitetit dhe Autorizimin për Vendosjen në Shërbim të Mjetit Lëvizës, si dhe*
- 2. Draft Rregullore Nr. xx-2017, Për metodat e përbashkëta të sigurisë për vlerësimin e konformitetit me kërkesat për marrjen e certifikatës së sigurisë hekurudhore.*

Kurse sa i përket përgatitjes së rregulloreve për rregullat nacionale të sigurisë, kemi mbajtur një takim me datë: 21-22.11.2017 me Agjencionin Evropian për hekurudha në Valenciennes të Francës, ku është diskutuar për të gjitha rregulloret të cilat janë përdorur nga hekurudhat e Shqipërisë, ish Jugosllavisë dhe Turqisë. Bazuar në këtë është propozuar

qe të krijohet një grup punues nga të gjitha vendet e IPA-s me qëllim të përgatitjes së rregullave nacionale të sigurisë të cilat do të vlenin për të gjitha shtetet të përfshira në programin e IPA-s.

ii. Shqyrtimi i aplikacioneve për dhënien e autorizimit për futjen në shërbim të mjeteve lëvizëse

Gjatë vitit 2017 janë shqyrtuar disa aplikacione për marrjen e Autorizimit për Futjen në Shërbim të mjeteve lëvizëse në pronësi të Railtrans-it (një lokomotivë) si dhe të Trainkos-it (dhjetë vagonë të udhëtarëve). Të gjitha procedurat për dhënien e autorizimit për futjen në shërbim të mjeteve lëvizëse të përshkruara më poshtë janë kryer duke u bazuar në Ligjin për Hekurudhat e Kosovës, Nenet: 18, 109, dhe 110 si dhe Direktivës Evropiane: Nr. 2004/49/EU, 2008/57/EU për këtë fushë.

Mjetet lëvizëse të autorizuara për tu futur në shërbim gjatë këtij viti kanë qenë gjithsej 11 copë, siç janë:

- 3) *Railtrans me datë: 21.02.2017 ka aplikuar për marrjen e Autorizimit për futjen në shërbim të 1 (një) Lokomotive dizel-hidraulike për transport të mallrave me Nr. 55231-5 të serisë.*
- 4) *Trainkos me datë: 20.04.2017, ka aplikuar për marrjen e autorizimit për futjen në shërbim për 10 (dhjetë) vagonë të udhëtarëve.*

Operatori për transport të mallrave Railtrans L.L.C me datë: 21.02.2017 ka aplikuar për marrjen e Autorizimit për futjen në shërbim për Lokomotivën për transport të mallrave. Pas analizimit të detajuar të të gjithë dokumentacionit të dorëzuar, është kërkuar dokumentacion shtesë për testet e kryera dhe raportin e pranimit teknik të lokomotivës.

Pas vlerësimit të dokumentacionit shtesë të ofruar nga Railtrans L.L.C në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi, kemi vlerësuar se të gjitha kërkesat ligjore janë përmbushur dhe në këtë mënyrë me datë: 05.05.2017 kemi dhënë Autorizimin për futjen në shërbim për Lokomotivën për transport të mallrave.

Më datë: 05.05.2017, kemi dhënë Autorizimin për futjen në shërbim për lokomotivën dizel-hidraulike

Ndërsa operatori për Operim me Trena të Hekurudhave të Kosovës Trainkos Sh.A. me datë 20.04.2017 ka aplikuar për marrjen e Autorizimit për futjen në shërbim për vagonët e udhëtarëve. Pas vlerësimit të dokumentacionit të ofruar nga Trainkos Sh.A për 10 (dhjetë) vagonët e udhëtarëve, në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi kemi vlerësuar se të gjitha kërkesat ligjore janë përmbushur dhe në këtë mënyrë me datë: 01.06.2017 kemi dhënë Autorizimin për futjen në shërbim për këta 10 (dhjetë) vagonë të udhëtarëve.

Me datë: 01.06.2017, kemi dhënë Autorizimin për futjen në shërbim për dhjetë vagonë të udhëtarëve

iii. Përgatitja e Raportit Vjetor të Sigurisë

Sikurse në vitet e kaluara edhe këtë vit është përgatitur Raporti Vjetor i Sigurisë i cili duhet përgatitet çdo vit, siç parashihet me Ligjin për Hekurudhat e Kosovës. Ky raport duhet të përfundohet dhe dorëzohet deri në fund të shtatorit të vitit vijues. Gjithashtu sipas Ligjit, të gjithë menaxheret e infrastrukturës (MI) dhe ndërmarrjet hekurudhore (NH) para 30 qershorit duhet të paraqesin Raportin Vjetor të Sigurisë në lidhje me vitin kalendarik të mëparshëm te organi përgjegjës për siguri. Gjithashtu përgatitja e raportit vjetor të sigurisë është e paraparë edhe në direktivën Nr. 2004/49/EC, nenin 9 paragrafi 4, të cilave ARH i'u referohet gjatë aktiviteteve të veta.

Raporti vjetor i përgatitur nga organi i sigurisë hekurudhore bazohet në të dhënat e dorëzuara në raportet e sigurisë të MI dhe NH, si dhe nga aktivitetet e organit të sigurisë nga viti paraprak.

Raporti duhet të përshkruaj të gjitha informatat e sigurisë lidhur me zhvillimet që kanë të bëjnë me sigurinë hekurudhore, ndryshimet në legjislacion, zhvillimet në Certifikatën/Autorizimin e sigurisë, raportet nga mbikëqyrja e menaxherit të infrastrukturës dhe të ndërmarrjeve hekurudhore, mirëmbajtjen e infrastrukturës dhe mjeteve lëvizëse, etj. Ndërmarrja hekurudhore Railtrans, me datë: 21.06.2017 ka dorëzuar në ARH Raportin Vjetor të Sigurisë për vitin 2016

Më datë:21.06.2017, Railtrans ka dorëzuar në ARH raportin vjetor të sigurisë për vitin 2016

Menaxheri i infrastrukturës hekurudhore Infrakos, me datë: 28.06.2017 ka dorëzuar në ARH Raportin Vjetor të Sigurisë për vitin 2016.

Më datë: 28.06.2017, Infrakos ka dorëzuar në ARH raportin vjetor të sigurisë për vitin 2016

Ndërmarrja hekurudhore Trainkos, me datë: 29.06.2017 ka dorëzuar në ARH Raportin Vjetor të Sigurisë për vitin 2016.

Më datë: 29.06.2017, Trainkos ka dorëzuar në ARH raportin vjetor të sigurisë për vitin 2016

Bazuar në raportet vjetore të menaxherit të infrastrukturës, dy ndërmarrjeve hekurudhore si dhe bazuar në informatat e mbledhura nga aktivitetet tona gjatë vitit 2016, ne me datë: 29.09.2017, kemi përgatitur raportin vjetor të sigurisë të cilin e kemi dërguar te Drejtori i Përgjithshëm i ARH-së.

Më datë: 29.09.2017, kemi përfunduar dhe dorëzuar raportin vjetor të sigurisë për vitin paraprak

iv. Inspektimi i infrastrukturës hekurudhore në menaxhim të infrakos-it

Inspektimin e infrastrukturës hekurudhore në menaxhim të menaxherit të infrastrukturës hekurudhore Infrakos e kemi filluar në muajin Shtator dhe e kemi përfunduar në muajin Tetor 2017. Gjatë procesit të inspektimit janë përfshirë pothuajse të gjithë faktorët të cilët direkt apo indirekt kanë të bëjnë me sigurinë në hekurudhë. Janë inspektuar stacionet, sinjalizimi, ndërrueset, traversat, rampat, kalimet në nivel (kryqëzimet rrugë-hekurudhë), urat, tunelet, ndriçimi, balasti, mirëmbajtja pranë vijës hekurudhore, etj.

Linjat të cilat janë inspektuar:

- a) Prishtinë - Fushë Kosovë, (05.09.2017)
- b) Fushë Kosovë - Pejë, (27.10.2017)
- c) Fushë Kosovë-Hani i Elezit, (20.10.2017)
- d) Fushë Kosovë-Miradi, (09.09.2017)
- e) Prishtinë-Podujevë, (12.10.2017)
- f) Fushë Kosovë-Mitrovicë, (18.10.2017)
- g) Klinë-Prizren, (19.09.2017)

Pas inspektimit të secilës linjë është përgatitur nga një raport lidhur me të gjeturat gjatë inspektimit. Në këto raporte jemi fokusuar që të evidentojmë jo vetëm mangësitë të cilat ekzistojnë në secilën linjë veç e veç por kemi evidentuar edhe punët të cilat janë kryer nga ana e kompanisë Infracos. Gjatë inspektimit të linjave është konstatuar se është punuar në mirëmbajtjen e gjeometrisë së linjave, balastit, ndërrueseve, sinjalizimit në stacione dhe traversave, kurse mbetet të punohet në sigurimin e vendkalimeve dhe sinjalizim. Në këto pjesë vlerësojmë që duhet të punohet më shumë. Shumë vendkalime shtrihen në vendbanime dhe frekuentimi nga ana e banorëve dhe automjeteve është mjaft i madh. Në disa pjesë ka mungesë të sinjalizimit me shenja të komunikacionit rrugor, sigurim me semafor apo barriera (rampë). Këto vendkalime vlerësojmë se janë pikat me të rrezikshme të identifikuar nga ana e jonë.

Mbetet shqetësuese numri i madhe i vendkalimeve në nivel të pasiguruara, qoftë i atyre legale apo ilegale të hapura nga Ministria, Komuna, kompanitë apo nga palët e treta gjatë ndërtimit të akseve të reja rrugore.

Bazuar në rezultatet e dala nga inspektimi, ARH ka përgatitur raportin me rekomandime të sigurisë për linjat e inspektuara dhe i është dërguar Infracosit

v. Inspektimi i mjeteve lëvizëse hekurudhore në menaxhim të Infrakos-it

Në bazë të detyrave dhe përgjegjësisë ligjore dhe konform Planit të Punës, bazuar në Ligjin për Hekurudhat e Kosovës është paraparë inspektimi i mjeteve lëvizëse.

Inspektimi i mjeteve lëvizëse hekurudhore në menaxhim të menaxherit të infrastrukturës Infrakos është realizuar gjatë muajit Nëntor 2017.

Gjatë procesit të inspektimit janë përfshirë pothuajse të gjitha mjetet lëvizëse të cilat përdorën nga Infrakos, siç janë:

4. Pllaser & Theurer,
5. Atlas,
6. Robel,
7. Iveco Daily,
8. Vagon Matës,
9. Vagon Bot Cisterna,
10. Motor i lehtë hekurudhorë,
11. Vagon sallon pune,
12. Rimorkio e hapur,
13. Rimorkio për saldim,
14. Matës për profil të tuneleve,
15. Valterë

Janë inspektuar këta parametra të sigurisë: Dimensionet e profilit të rrotave, trashësia e rrotave, papuçet e frenimit, sistemi i frenimit, hapja dhe mbyllja e dyerve, sistemi i ndriçimit, buria dhe radio lidhja, lidhëset e ajrit, çengeli etj.

Për të gjitha këto mjete lëvizëse hekurudhore është përgatitur nga një raport, ku kemi paraqitur të gjeturat gjatë procesit të inspektimit. Gjatë vitit 2018, do të mbikëqyrim implementimin e rekomandimeve të cilat janë paraqitur në raporte.

Bazuar në rezultatet e dala nga inspektimi, ARH ka përgatitur raportin me rekomandime të sigurisë për mjetet lëvizëse të mirëmbajtjes dhe i është dërguar Infrakosit

vi. Inspektimi i mjeteve lëvizëse hekurudhore të Trainkos-it

Inspektimi i mjeteve lëvizëse hekurudhore në menaxhim të kompanisë hekurudhore Trainkos, është realizuar gjatë muajit Nëntor 2017.

Janë inspektuar të gjitha mjetet lëvizëse hekurudhore të cilat janë në Regjistrin Nacional të Mjeteve lëvizëse, në pronësi të Trainkos-it, siç janë:

4. Lokomotivat
5. Lokomotivat Manovruese
6. Trenat Motorik
7. Vagonët e Udhëtarëve

Për secilin mjet lëvizës të inspektuar është përgatitur nga një raport me të gjeturat gjatë inspektimit. Në raport janë përfshirë disa nga të gjeturat për të cilat ne kemi menduar se janë më të rëndësishme.

Janë identifikuar me fotografi dhe komente të gjeturat kryesore si dhe kemi dhënë disa rekomandime/komente se çfarë duhet të ndërmerret më qëllim të përmirësimit të gjendjes ekzistuese. Gjatë vitit 2018 do të mbikëqyrim implementimin e rekomandimeve të cilat janë paraqitur në raport.

Bazuar në rezultatet e dala nga inspektimi, ARH ka përgatitur raportin me rekomandime të sigurisë për mjetet lëvizëse të inspektuara dhe i është dërguar Trainkos-it

vii. Inspektimi i mjeteve lëvizëse hekurudhore në menaxhim të Railtrans-it

Gjatë vitit raportues është realizuar inspektimi i mjeteve lëvizëse të operatorit privat Railtrans i cili operon vetëm me transport të mallrave. Ky operator ka në menaxhim dy (2) lokomotiva të cilat janë inspektuar gjatë muajit Dhjetor 2017. Janë inspektuar mjetet lëvizëse hekurudhore të cilat janë në Regjistrin Nacional të Mjeteve lëvizëse, në pronësi të Railtrans-it.

Për këto mjete lëvizëse të inspektuara është përgatitur një raport me të gjeturat gjatë inspektimit. Në raport janë përfshirë të gjeturat për të cilat kemi vlerësuar se janë më të rëndësishme.

Për këto mjete lëvizëse nuk kemi pasur ndonjë rekomandim të veçantë, por kemi sugjeruar që të vazhdohet me mirëmbajtjen e rregullt të këtyre lokomotivave.

Bazuar në rezultatet e dala nga inspektimi, ARH ka përgatitur raportin me rekomandime të sigurisë për mjetet lëvizëse të inspektuara dhe i është dërguar Railtrans-it

viii. Inspektimi i mjeteve lëvizëse hekurudhore në menaxhim të ferronikelit

Gjithashtu janë inspektuar edhe 24 (njëzet e katër) vagonët e mallrave në menaxhim të Ferronikel-it. Inspektimi është realizuar gjatë muajit Tetor 2017. Në raport janë paraqitur disa të gjetura ku edhe janë dhënë rekomandime se çfarë duhet të ndërmerret më qëllim të rritjes së sigurisë gjatë operimit me këta vagonë.

Bazuar në rezultatet e dala nga inspektimi, ARH ka përgatitur raportin me rekomandime të sigurisë për mjetet lëvizëse të inspektuara dhe i është dërguar Ferronikelit-it

Fusha e Interoperabilitetit

i. Mjetet Hekurudhore të Kosovës që gjenden jashtë territorit të Republikës së Kosovës

ARH si organ përgjegjës për Interoperabilitetin Hekurudhor në Kosovë, në bashkëpunim me Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik (MZHE), menaxherin e infrastrukturës hekurudhore Infrakos dhe operatorin me trena Trainkos, ka realizuar regjistrimin e mjeteve lëvizëse (MLJK) që janë pronë e hekurudhave të Kosovës të cilat gjenden jashtë territorit të

Republikës së Kosovës që nga pas lufta. Regjistrimi është bazuar në regjistrin e vitit 1989 siguruar nga arkiva e Trainkos-it.

Duke marrë për bazë regjistrin e vitit 1989 (dokument i vetëm referues për këtë regjistrim), grupi punues më datë 16.02.2017 ka filluar me krijimin e regjistrit të (MLJK). Regjistrimi është realizuar përmes grupit punues i përbërë nga ARH, MZHE, Trainkos dhe Infracos. Procesi i regjistrimit të (MLJK) ka zgjatur katërbëdhjetë (14) ditë përgjatë katër muajve dhe ka përfunduar më datë 12.05.2017.

Në regjistër janë vendosur të dhënat si në vijim:

1. Numri i inventarit
2. Numri i mjetit lëvizës
3. Seria
4. Kategoria e mjetit lëvizës
5. Viti i prodhimit të mjetit lëvizës
6. Pronësia
7. Vendndodhja
8. Data e regjistrimit

Regjistri i vitit 1989 ka përfshirë gjithsejtë 1819 mjete lëvizëse hekurudhore. Me largimin e njëmbëdhjetë (11) mjeteve nga regjistri NVR dhe pesëmbëdhjetë (15) mjeteve nga marrëveshja për shkëmbimin e vagonëve të mallrave në mes të Hekurudhave të Kosovës (HK) dhe Hekurudhave të Kroacisë ky regjistër pëson ndryshime.

Gjithsejtë janë të regjistruara 1796 mjete lëvizëse. ARH edhe pas përfundimit të krijimit të regjistrit të (MLJK), ka kërkuar nga kompanitë hekurudhore Trainkos dhe Infracos që të kontrollojnë arkivat nëse ekzistojnë edhe regjistra/dokumente të tjerë të cilët mund të ndihmojnë në saktësimin e numrit të këtyre mjeteve. Megjithatë, përveç regjistrit të vitit 1989 kompanitë nuk kanë arritur që të gjejnë dokumente të tjera që mbulojnë të gjitha mjetet e kësaj kategorie. Përfundimisht bazuar në regjistrin e vitit 1989 regjistri i mjeteve lëvizëse hekurudhore, pronë e Hekurudhave të Kosovës që gjenden jashtë territorit të Republikës së Kosovës përbëhet prej **1796** mjete lëvizëse hekurudhore dhe përfshinë këto kategori:

- a. Lokomotiva
- b. Trena Motorik
- c. Vagonë të mallrave

d. Vagonë të udhëtareve

e. Vagonë për nevoja të veçanta

Bazuar në këtë regjistër është përgatitur raporti dhe lista e të gjitha mjeteve që aktualisht gjenden jashtë territorit tonë që përfshinë gjithsejtë 1796 mjete hekurudhore.

Me datë 10.11.2017 Raporti është dërguar në Komisionin Parlamentar për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri, Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik, Ministrinë e Infrastrukturës, Infrakos dhe Trainkos.

ii. Regjistrimi i mjeteve lëvizëse hekurudhore

ARH është përgjegjëse për numërimin e mjeteve transportuese të cilat janë në shërbim në Kosovë dhe për mbajtjen e regjistrit ad hoc me të gjitha informatat e kërkuara siç janë përshkruar në Ligjin për Hekurudhat. ARH ka mbikëqyrë se a janë regjistruar mjetet lëvizëse dhe nëse informacioni që ka të bëjë me sigurinë në regjistrin nacional është i azhurnuar.

Gjatë vitit raportues është realizuar regjistrimi i mjeteve lëvizëse hekurudhore për të cilat ka aplikuar Operatori me Trena Trainkos dhe Operatori Privat Railtrans. Mjetet e regjistruara i janë bashkëngjitur NVR-së, (tabela 3). Gjithashtu kemi pranuar dhe realizuar aplikimet për modifikimin e një vagoni të mallrave nga Trainkos (tabela 4)

Në forme tabelare janë paraqitur detajet e mjeteve lëvizëse hekurudhore për të cilat është aplikuar për regjistrim (tabela 3 dhe 4).

Tabela 3: Mjetet lëvizëse hekurudhore të regjistruara në vitin 2017

Nr	Mjeti lëvizës	Kompania	Viti i prodhimit	Numri paraprak	Numri evropian	
1	Lokomotivë	RAILTRANS	1989	55231-5	92 00 2740 002-6	Regjistruar
2	Vagonë i udhëtareve	TRAINKOS	1967	50 80 8435 037-2	50 00 8435 022-1	Regjistruar
3	Vagonë i udhëtareve	TRAINKOS	1968	50 80 2235 306-6	50 00 2235 023-4	Regjistruar
4	Vagonë i udhëtareve	TRAINKOS	1968	50 80 2235 326-4	50 00 2235 024-2	Regjistruar
5	Vagonë i udhëtareve	TRAINKOS	1968	50 80 2235 301-7	50 00 2235 025-9	Regjistruar
6	Vagonë i udhëtareve	TRAINKOS	1966	50 80 2235 350-4	50 00 2235 026-7	Regjistruar
7	Vagonë i udhëtareve	TRAINKOS	1968	50 80 8435 006-7	50 00 8435 027-0	Regjistruar
8	Vagonë i udhëtareve	TRAINKOS	1966	50 80 8435 023-2	50 00 8435 028-8	Regjistruar
9	Vagonë i udhëtareve	TRAINKOS	1968	50 80 8435 033-1	50 00 8435 029-6	Regjistruar
10	Vagonë i udhëtareve	TRAINKOS	1968	50 80 2235 360-3	50 00 2235 030-9	Regjistruar
11	Vagonë i udhëtareve	TRAINKOS	1965	50 80 3135 114-3	50 00 3135 031-6	Regjistruar

Tabela 4. Mjetet lëvizëse hekurudhore të modifikuara në vitin 2017

Nr	Mjeti lëvizës	Kompania	Viti i prodhimit	Numri paraprak	Numri evropian	
1	Vagonë i mallrave	TRANKOS	1962	80 72 9300 049-1	80 00 9300 042-3	Modifikuar

ARH ka shqyrtuar të gjithë formularët e regjistrimit konform legjislacionit në fuqi dhe në afat kohorë të përcaktuar në Ligjin për Hekurudhat e Kosovës, Direktivën për Interoperabilitet 2008/57/EC dhe Rregullorën 05/2012 për Regjistrimin Nacional të Mjeteve Lëvizëse.

iii. Krijimi i databazës për mjetet me pronësi të pa definuar

Lista e mjeteve me pronësi të pa definuar (MPPD) gjendet si shtojcë në Raportin e regjistrimit 2015 dhe shtojcë në Raportin e inspektimit të vitit 2016. Për shkak të numrit të madh dhe sistematizimeve bazuar në kategori dhe ndarje sipas pronësisë, përfshirë dhe imazhet e secilit mjet, ka qenë i nevojshëm klasifikimi i tyre në një metodë më të sofistikuar. Databaza është metoda më e përshtatshme e arkivimit të mjeteve të kësaj kategorie. ARH ka vlerësuar si të arsyeshme krijimin e kësaj databaze elektronike e cila do të përfshijë dhe përmbledhë të gjitha të dhënat e mjeteve të kësaj kategorie (MPPD), marrë për bazë regjistrimin e vitit 2015 dhe inspektimin e vitit 2016. Si rrjedhojë është krijuar komisioni brenda ARH-së i cili ka krijuar këtë databazë, e cila përfshinë të gjitha mjetet e kësaj kategorie që kanë formularët e regjistrimit dhe mjetet për të cilat nuk është arritur të plotësohen formularët e regjistrimit.

Të dhënat identifikuese të mjeteve MPPD përfshijnë:

2. Numri paraprak identifikues, përfshirë numrin serik
3. Numrin e boshteve

4. Pronësia
5. Lokacioni
6. Data e revizionit
7. Burimi i informacionit për mjetin lëvizës

Gjithashtu në databazë përfshihen edhe komentet/shpjegimet për të gjitha rastet kur të dhënat e mjeteve nuk kanë qenë të qarta. Të dhënave për secilin mjet lëvizës i është bashkëngjitur edhe fotografia.

Në këtë databazë janë arkivuar gjithsejtë 509 mjete lëvizëse hekurudhore që kanë pronësi të pa definuar.

iv. Azhurnimi i regjistrit të mjeteve lëvizëse NVR

ARH, përveç mbajtjes së regjistrit nacional të mjeteve lëvizëse (NVR), ndër të tjera është përgjegjëse edhe për përditësimin e tij. Në vitin 2017 si rezultat i regjistrimeve të reja të mjeteve lëvizëse por edhe modifikimeve kemi azhurnuar regjistrin NVR.

Tabela 5: Ndërmarrjet hekurudhor mjetet lëvizëse të të cilëve janë pjesë e NVR.

NDËRMARRJA HEKURUDHOR	STATUSI	UEB-FAQJA
Infrastruktura Hekurudhore e Kosovë INFRAKOS	Në përdorim	www.kosovorailway.com
Operimi me trena TRAINKOS	Në përdorim	www.trainkos.com
Newco Ferronikeli Complex L.L.C	Në përdorim	www.cunicoresources.com
Railtrans	Në përdorim	www.railtrans.biz

v. Azhurnimi i marrëveshjeve ndërkombëtare dhe vendore të ndërmarrjeve hekurudhore

Bazuar në marrëveshjet ndërkombëtare të arritura në mes të institucioneve dhe kompanive në sektorin hekurudhor, ARH ka të krijuar listën e marrëveshjeve ndërkufitare e cila azhurnohet përmes marrëveshjeve të reja ose atyre që pësojnë ndryshime. Në listë janë të përfshira edhe marrëveshjet vendore të menaxherit të infrastrukturës dhe ndërmarrjeve hekurudhore mbi operimin dhe mirëmbajtjen. Palët nënshkruese njoftojnë ARH-në mbi marrëveshjet e nënshkruara, të cilat i bashkëngjiten listës së këtyre marrëveshjeve.

Azhurnimi i fundit është realizuar në muajin Shtator 2017, si rezultat i nënshkrimit të marrëveshjes në mes të operatorit privat Railtrans dhe “MZ Transport”- Maqedoni.

1. Marrëveshje për bashkpunim të ndërsjelltë për transportin hekurudhor, nënshkruar më datë 14.02.2017.

Informacione të detajuara mbi marrëveshjet që gjinden në tabelën e më poshtme:

Tabela 6: Marrëveshjet ndërkombëtare dhe vendore Hekurudhore të Kosovës

Nr.	Marrëveshjet	Palët nënshkruese	Data e nënshkrimit	Koment
1	Marrëveshja e përkohshme ndërmjet NHT "Beograd" dhe Hekurudhat e UNMIK-ut të	Hekurudhat e UNMIK-ut - NHT"Beograd"	31.05.2002 (nuk implementohet)	Nuk zbatohet që nga 03 Marsi 2008, si pasojë e masave të ndërmarra nga entitetet lokale të pjesës veriore të vendit pas shpalljes së pavarësisë së Republikës së Kosovës.
2	Marrëveshja e përkohshme në mes të: "Hekurudhat e Maqedonisë" dhe "Hekurudhat e UNMIKU-ut"	Hekurudhat e UNMIK-ut - Hekurudhat Maqedone	30.08.2002	Transporti hekurudhorë ndërmjet dy shteteve respektive, Republika e Maqedonisë dhe Republika e Kosovës ende bëhet sipas kësaj Marrëveshje. Rezultat i Marrëveshjes kornizë të datës 15.09.2011 është Marrëveshja implementuese për ndërlidhjen e përbashkët të rrjeteve Hekurudhore ndërmjet

				Hekurudhave të Maqedonisë-Infrastruktura dhe Hekurudhave të Kosovës e nënshkruar me datën 15.02.2016 për të cilën ende nuk është krijuar baza për zbatim.
3	Marrëveshja ndërmjet , Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Republikës së Maqedonisë mbi komunikacionin hekurudhor kufitar	Qeveria e Republikës së Kosovës – Qeveria e Republikës së Maqedonisë	15.09.2011	Kjo është kontratë kornizë dhe bazohet në Traktatin për transport. Pritet finalizimi i marrëveshjeve të palëve në fushat e veçanta: hekurudha, polici, dogana dhe shërbimet fitosanitare.
4	Marrëveshja për mirëmbajtje të binarit industrial	“New Co Ferronikeli Complex L.L.C.” - “Infrakos” Sh.A.	27.02.2012	Kontrata e nënshkruar më 27.02.2012 ka të precizuar kohën e paralajmërimit të shkëputjes së kontratës dhe është implementuar
5	Marrëveshja ndërkombëtare për kalimin ndërkufitar ndërmjet “Infrakos”Sh.A. – Kosovë dhe H.M. ”Infrastruktura” - Maqedoni	“Infrakos” Sh.A. – H.M. ”Infrastruktura”	Pa-finalizuar	Kjo marrëveshje është finalizuar dhe është nënshkruar nga “INFRAKOS”SH.A. – Kosovë dhe H.M. ”INFRASTRUKTURA” - Maqedoni Implementimi i sajë nuk bëhet sepse për implementimin e sajë duhet edhe nënshkrimi i akterëve tjerë si psh. : Policisë kufitare, organeve Fito Sanitare te te dyja Shteteve . Me të përbushjes së këtyre kërkesave ne jemi te gatshëm për Implementim.
6	Marrëveshja ndërmjet Trainkos Sh.A. dhe Infrakos Sh.A. për Shërbime të përbashkëta,,	Trainkos Sh.A. - Infrakos Sh.A.	24.08.2015	Kontrata e nënshkruar më 24.08.2015 ka të precizuar kohën e paralajmërimit të shkëputjes së kontratës dhe mund të shtohet me aneks ndonjë pikë/ çështje e nevojshme.
7	Marrëveshja për qasjen në binarë “Infrakos” Sh.A. dhe “Trainkos” Sh.A.	Trainkos Sh.A. - Infrakos Sh.A.	Pa-finalizuar	Kjo Marrëveshje në kohën e raportimit (06.02.2017) është në shqyrtim të ndërsjellë për të u nënshkruar së shpejti.
8	Marrëveshja ndërmjet “New Co Ferrenikelin Coplex L.L.C.” dhe “Hekurudhat e Kosovës” për bartjen e xeheve dhe thëngjillit	“New Co Ferrenikelin Coplex L.L.C.” -Ish- Hekurudhat e Kosovës	E nënshkruar (30.12.2016)	Një kontratë me “New Co Ferronikeli Coplex LLC” është nënshkruar për periudhën Tetor – Dhjetorë 2016. Kontrata për vitin 2017 është nënshkruar për gjashtë muaj, pra për Janar – Qershor 2017 me mundësi vazhdimi varësisht nga rrethanat e krijuara.

9	Marrëveshjen për mirëmbajtjen e mjeteve lëvizëse ndërmjet “Trainkos Sh.A.” Dhe New Co Ferrenikelin Coplex L.L.C.”	“Trainkos” Sh.A. –“New Co Ferrenikelin Coplex L.L.C.”	17/04/2014 30.12.2016	Është pjesë e aneksit të kontratës gjashtëmujore të nënshkruar me datën 30.12.2016.
10	Marrëveshja implementuese për ndërlidhjen e përbashkët të rrjeteve Hekurudhore ndërmjet Hekurudhave të Maqedonisë-Infrastruktura dhe Hekurudhave të Kosovës,	H.M. “Infrastruktura” H.M. “Transporti” - “Trainkos” Sh.A. “Infrakos” Sh.A.	15.02.2016	Është e nënshkruar mes kompanive relevante hekurudhore të dy shteteve dhe pritet për veprime të mëtutjeshme të koordinuara nga MI-ja.
11	Dispozitat e përbashkëta për rregullimin e Komunikacionit kufitar hekurudhor në linjën kufitare Vollkovë-Hani I Elezit	H.M. “Infrastruktura” H.M. “Transporti” - “Trainkos” Sh.A. “Infrakos” Sh.A.	15.02.2016	Është e nënshkruar mes kompanive relevante hekurudhore të dy shteteve dhe pritet për veprime të mëtutjeshme të koordinuara nga MI-ja.
12	Marrëveshjen për qasjen në binarë ndërmjet Railtrans L.L.C. dhe Infrakos Sh.A.	“Railtrans L.L.C.” - “Infrakos Sh.A.”	07.10.2016	Numer protokolli 625
13	Kontratë për mirëmbajtje ,servis dhe riparim të lokomotivave	“Railtrans L.L.C.” - “Express Service Ltd”- Ruse ,Bulgaria	10.05.2016	
14	Marrëveshje për bashkpunim të ndërsjelltë për transportin hekurudhor	“Railtrans L.L.C.” - “Mz Transport Ad-Skopje”- Macedonia	14.02.2017	Numër protokolli 340/1

vi. Libri i Rregullave për Makinistë

Libri i rregullave për makinistë është një dokument në forme manuali në të cilin duhet të përshkruhen në forme të qartë të gjitha informacionet, procedurat dhe rregullat gjatë operimit të trenit dhe të jenë të njohura për makinistin (bazuar në nenin 106 të Ligjit për Hekurudha dhe pikën 4.2.1.2 të Rregullorës (BE) 2015/995). Ky informacion duhet të ketë parasysh operimin në situata normale, të degraduara dhe të emergjencës për rrugët gjatë të cilave operohet dhe për mjetet lëvizëse të përdorura në këto rrugë.

ARH ka përgatitur informacionin e përgjithshëm në bazë të të cilit duhet përgatitur ky dokument. Përgjegjës për përgatitjen e “Librit të Rregullave për Makinistë” është ndërmarrja hekurudhore.

Operatori me trena Trainkos bazuar në informacionet e përgjithshme të përgatitura nga ARH gjatë vitit 2017 ka përgatitur draftin final të “Librit të Rregullave për Makinistë” realizuar përmes grupit punues brenda Trainkos-it, përgjegjës për hartimin e këtij dokumenti. Ka mbetur që të përfshihen edhe rekomandimet e fundit të ARH-së që dokumenti të jetë i finalizuar.

Gjthashtu gjatë vitit 2017 operatori privat Railtrans me kërkesë të ARH-së ka filluar me përgatitjen e Librit të Rregullave për Makinistë.

Bazuar në rekomandimet e ARH-së, Railtrans ka finalizuar këtë dokument.

vii. Specifikacionet Teknike për Interoperabilitet (STI)

Specifikacionet Teknike për Interoperabilitet janë përgatitur dhe lëshuar në nivel të BE-së, në mënyrë që të përgatitet Hapësira Unike Hekurudhore dhe si të tilla duhet të paraqesin bazën kryesore të sigurisë hekurudhore në Kosovë.

Sipas Ligjit për Hekurudha, për secilin nënsistem hekurudhor, STI-të në Kosovë duhet të lëshohen nga ARH-ja dhe duhet t'i plotësojnë kërkesat esenciale e në veçanti kërkesat e sigurisë.

viii. Specifikacionet Teknike për Interoperabilitet për nënsistemin e infrastrukturës (STI INF)

ARH përgjegjëse për fushën e Interoperabilitetit është në proces të përgatitjes së STI INF, i cili do të ketë për bazë Rregulloren e BE-së me Nr. 1299/2014. Duke qenë se procedurat për vlerësimin e konformitetit dhe përshtatshmërisë për përdorimin e përbërësve të interoperabilitetit, si dhe procedurat për vlerësimin e verifikimit për nënsistemet hekurudhore me rregulloret e STI-ve realizohen nga Organet Njoftuese (në vendet e BE-së), fillimisht janë analizuar dy alternativat e mundshme të transpozimit:

a) Ndryshimi i Rregullorës Nr. 1299/2014 për STI INF, përshtatur për kushtet e sektorit tonë hekurudhore, ose

b) Adoptimi i Rregullorës Nr. 1299/2014 për STI INF

ARH duke i analizuar mundësitë e transpozimit ka vlerësuar se adoptimi i këtyre rregulloreve është mundësia e vetme e transpozimit edhe pse si akte nenligjore bartin standarde të larta për kushtet e sektorit tonë hekurudhor.

Për ta diskutuar formën e transpozimit të STI-ve, ARH ka realizuar një takim pune me Ministrin e Infrastrukturës nga i cili është përkrahur ideja që transpozimi të realizohet në formën e adoptimit.

ARH ka arritur që dokumentet në bazë të të cilave do të përgatitet Rregullorja për STI INF të jenë të gatshme. Duke qenë se transpozimi do të realizohet përmes adoptimit është e rëndësishme që përkthimi i rregulloreve bazike të jetë profesional. Ministria e Integritimit Evropian ka realizuar përkthimin e STI INF Nr. 1299/2014, e cila do të realizojë edhe certifikimin e përkthimit.

Në të njëjtën situatë jemi edhe me Specifikacionet Teknike për Interoperabilitet për nënsistemin e Operimit dhe Menaxhimit të Trafikut STI OPE. Ky akt nenligjor gjithashtu do të ketë për bazë Rregulloren e BE-së TSI Nr. 2015/995 për këtë nënsistem. Forma e transpozimit do të jetë e njëjtë me Rregulloren TSI për nënsistemin e Infrastrukturës.

Përgatitja dhe implementimi i STI-ve të do të kenë rol integruar të sistemit tonë hekurudhore në atë të BE-së, meqë lehtësojnë tranzicionin nga sistemet e vjetra kombëtare hekurudhore të cilat qeverisen kryesisht nga rregullat nacionale, në një zonë hekurudhore të përbashkët evropiane që qeveriset kryesisht nga rregullat e përbashkëta të BE-së.

ix. Inspektimi i regjistrimit të mjeteve lëvizëse

Bazuar në punën dhe përgjegjësitë e veta, ARH ka realizuar inspektimin e regjistrimit të mjeteve lëvizëse (NVR) që janë në pronësi dhe administrim të të gjitha ndërmarrjeve hekurudhore. Qëllimi i inspektimit ka qenë për të kontrolluar nëse të gjitha mjetet lëvizëse hekurudhore brenda territorit të Kosovës janë pjesë e NVR-së. Kjo nënkupton përputhshmërinë e mjeteve lëvizëse operuese hekurudhore me NVR-në. Vlerësojmë që

përmes inspektimit të parandalohet operimi me mjete të paregjistruara e cila do të ishte në kundërshtim me Rregulloren 05/2012.

Inspektimit NVR iu nënshtruan mjetet e Infrakos-it, Trainkos-it, NewCo Ferronikeli Complex dhe Railtrans-it.

Gjatë inspektimit është konstatuar se të gjitha mjetet lëvizëse me të cilat operojnë ndërmarrjet hekurudhore ishin pjesë e NVR-së. Me rezultatet e dala nga inspektimi janë përgatitur raportet për katër kompanitë që kanë përfshirë të gjitha mjetet hekurudhore në pronësi dhe administrim të Infrakos-it, Trainkos-it, NewCo Ferronikeli Complex dhe Railtrans-it.

x. Shënjimi i numrit evropian në mjetin lëvizës

Në inspektimin NVR-së është përfshirë edhe kontrollimi i shënjimit të numrit evropian. Secili mjet lëvizës hekurudhor i cili është pjesë e NVR-së duhet të ketë të shënuar numrin evropian dymbëdhjetë shifror, përmes të cilit identifikohet secili mjet. Inspektimi i shënjimit të numrit evropian rezultoi të jetë i suksesshëm, sepse të gjitha mjetet e Infrakos-it, Trainkos-it, Railtrans-it dhe Ferronikel-it të cilat janë pjesë e NVR kishin të shënuar këtë numër identifikues të regjistrimit në mjet.

xi. Shënjimi i Mbajtësit të Mjetit Lëvizës (VKM)

VKM-ja (Vehicle Keeper Marking) është pasqyrim i emrit të plotë apo shkurtesës së mbajtësit të mjetit lëvizës. Shënjimi i mbajtësit të mjetit lëvizës është një kod alfa numerik i përbërë prej 2 deri në 5 karaktere i cili duhet të jetë i mbishkruar në secilin mjet lëvizës hekurudhor, afër numrit të mjetit lëvizës.

ARH është përgjegjëse për pranimin dhe njohjen e kodit të VKM-së propozuar dhe aplikuar nga mbajtësi i mjeteve lëvizëse. ARH kontrollon kodin e VKM-së të propozuar nga mbajtësi i mjetit lëvizës i cili duhet të jetë unik nga secili kod ekzistues i mbajtësve të tjerë brenda territorit të Republikës së Kosovës.

VKM duhet të mbishkruhet në secilin mjet lëvizës hekurudhor. ARH sipas Rregullorës për Regjistrin Nacional të mjeteve lëvizëse ka për detyrë të organizojë regjistrin e VKM-së, ku

çdo mbajtës i mjeteve lëvizëse i cili regjistrohet dhe pranohet nga ARH, duhet të ketë kodin e VKM-së.

Bazuar në këtë, ARH në vitin 2017 ka iniciuar procesin e mbishkrimit të kodit të VKM-së në mjetet lëvizëse për të gjitha kompanitë hekurudhore. Tani kur tregu në Kosovë është i hapur dhe kemi më shumë se një operator hekurudhor është e nevojshme që mjetet e secilit mbajtës të identifikohen qartë edhe kur janë në qarkullim.

1. Trainkos me datë 19.12.2017 ka realizuar procesin e mbishkrimit të kodit të VKM-së në të gjitha mjetet lëvizëse hekurudhore të cilat janë pjesë e NVR-së.
2. Railtrans me datë 05.12.2017 ka realizuar procesin e mbishkrimit të kodit të VKM-së në të gjitha mjetet lëvizëse hekurudhore (Lokomotiva) të cilat janë pjesë e NVR-së.
3. NewCo Ferronikeli Complex me datë 05.12.2017 ka realizuar procesin e mbishkrimit të kodit të VKM-së në të gjitha mjetet lëvizëse hekurudhore (vagonët e mallrave) të cilat janë pjesë e NVR-së.

Tabela 7. Kodi i VKM-së për ndërmarrjet hekurudhore

	VKM	UNIKE	STATUS		
Sqarime:	Kodi që shihet në mjetin lëvizës	Kontrollimi i kodeve unike	Blokuar	Në përdorim	Revokuar

VKM	UNIKE	Emri i VKM	Shteti	Statusi	Webfaqja
IHK	IHK	INFRAKOS	KS	Në përdorim	www.kosovorailëay.com
NCF	NCF	NEWCO FERRONIKELI COMPLEX L.L.C	KS	Në përdorim	www.cunicoresources.com
TRKOS	TRKOS	TRAINKOS	KS	Në përdorim	www.trainkos.com
RT	RT	RAILTRANS	KS	Në përdorim	www.railtrans.biz

xii. Inspektimi i Shënjjimit të mbajtësit të mjetit lëvizës

Qëllimi i Inspektimit është për të kontrolluar nëse në të gjitha mjetet hekurudhore brenda territorit të Republikës së Kosovës që janë pjesë e NVR-së, është aplikuar shënjjimi i VKM-së dhe për të kontrolluar nëse ky shënjjim është realizuar në përputhje me kriteret e shënjjimit të VKM-së, sipas Rregullorës së NVR-së. Inspektimit iu nënshtruan mjetet e Trainkos-it, Railtrans-it dhe të NewCo Ferronikeli Complex. Ky është viti i parë i inspektimit të kodit të VKM-së ku të gjitha mjetet lëvizëse me të cilat operojnë ndërmarrjet hekurudhore kishin të mbishkruar kodin e VKM-së. Me rezultatet e dala nga inspektimi janë përgatitur raportet për tri kompanitë që kanë përfshirë të gjitha mjetet hekurudhore në pronësi dhe administrim të Trainkos-it, Railtrans-it dhe NewCo Ferronikeli Complex.

Fusha e Rregullimit të Tregut

i. Procesi i konsultimit për Ekspozeun e Rrjetit

Në muajin Maj 2017 ARH ka pranuar draftin e Ekspozeut të Rrjetit 2018 (ERR) prej menaxherit të infrastrukturës hekurudhore Infracos, i cili është përgjegjës për përgatitjen dhe propozimin e ERR-së. Që nga pranimi i këtij drafti, ARH ka filluar një proces intensiv të konsultimeve duke përfshirë të gjitha palët e interesit siç janë: Infracos, Trainkos, Railtrans, Ministria e Infrastrukturës (MI) si dhe Ministria e Zhvillimit Ekonomik (MZHE).

ARH, me datë 28.06.2017 ka mbajtur takim konsultativ me të gjitha palët e interesit për procesin e konsultimeve për draft ERR 2018. Temë specifike e diskutimit në këtë takim ka qenë kapitulli i gjashtë (6) i draft ERR 2018 me përshkrimin, shërbimet e përfshira në tarifa, principet e llogaritjes së detyrimeve, pra mënyra e llogaritjes së tarifave nga ana e menaxherit të infrastrukturës Infracos.

Infracos ka argumentuar të dhënat e kapitullit të gjashtë, ku sipas tyre këto janë çmimet reale për mirëmbajtje të infrastrukturës hekurudhore. Ndërmarrja hekurudhore Trainkos në

ketë takim ka paraqitur vërejtjet e tyre lidhur me draft ERR 2018, posaçërisht ka pasur ankesa për pikat e përmendura më lartë sidomos për kapitullin e gjashtë.

Lidhur me këtë ARH ka filluar të mbledhë dhe analizoj faktet lidhur me vërejtjet e paraqitura nga ana e Trainkos-it, për çmimet e operimit në infrastrukturën hekurudhore si dhe krahasimin me atë të vendeve fqinjë siç janë: Maqedonia dhe Mali i Zi. ARH pas një procesi të gjithanshëm të konsultimeve me palët e interesit, ka paraqitur opinionin e vet për pikat e caktuara në draft ERR 2018.

ii. Shqyrtimi i ankesave

• Shqyrtimi i ankesës për kapitullin e gjashtë të ERR 2018

Në kuadër të aktiviteteve tona, ne si ARH kemi bërë shqyrtimin e ankesave të pranuar nga ndërmarrjet hekurudhore. Ndër ankesat që ne kemi trajtuar në kuadër të kompetencave ligjore ka qenë *ankesa e pranuar me datë 02.08.2017, për draft ERR 2018 nga operatori privat Railtrans.*

Pikat e paraqitura në ankesë nga ana e Railtrans-it janë si në vijim:

- Niveli shumë i lartë i tarifave;
- Koeficienti i Trenave TCO;
- Koeficienti i Kualitetit të mjeteve tërheqëse QIT;
- Koeficienti i Zhurmës QIN;
- Shfrytëzimi dhe qasja në objektet për pastrim, Larjen e Trenave dhe Vagonëve;
- Shfrytëzimi i Objekteve për pranim dhe përcillje të udhëtareve;
- Shfrytëzimi dhe vendosja e vagonëve;
- Shfrytëzimi dhe qasja e vagonëve në binarët industrial;
- Shfrytëzimi i binareve për parkimin e vagonëve;
- Qasja deri te objektet për mirëmbajtje dhe objekte tjera teknike;
- Manovrimi formimi i trenave të udhëtareve dhe përgatitja e dokumentacionit për trenat e udhëtareve në nisje;
- Shitja e biletave;
- Evidentimi dhe udhëheqja e evidencave vagonore;

ARH, pas shqyrtimit të pikave të kësaj ankese ka dhënë këtë opinion:

ARH-ja, respektivisht Organi për Rregullimin e Tregut, bazuar në informacionin e pranuar ka ardhur deri tek konstatimi se ky draft ERR 2018 në parim është në përputhje me Ligjin për Hekurudhat e Kosovës nr. 04/L-063, Udhëzimin Administrativ Nr. 02/2013 për Llogaritjen e Shpenzimeve të Drejtpërdrejta për Mirëmbajtjen e Infrastrukturës Hekurudhore, Udhëzimin Nr.03/2013 për Vendosjen, Përcaktimin dhe Arkëtimin e Pagesave të Qasjes në Infrastrukturë dhe me Rregulloren për Ekspoze të Rrjetit Nr. 01/2013. Duke pasë parasysh se një nga detyrat e ARH-së si organ i Rregullimit të Tregut është sigurimi që pagesat e vendosura nga menaxheri i infrastrukturës apo organi i vendosjes së pagesave nuk janë diskriminuese, duke u bazuar në Nenin 25, pika 3.1. dhe 3.2 e Ligjit për Hekurudhat e Kosovës, i cili siguron që qasja në binar, stacione, depot e operatorit që plotësojnë kushtet e domosdoshme të jetë e drejtë, transparente dhe jo diskriminuese. ARH-ja, respektivisht Organi për Rregullimin e Tregut ka analizuar situatën e tregut bazuar në informacionin e pranuar dhe ka ardhur deri tek konstatimi se tarifatat e propozuara nga menaxheri i infrastrukturës në kapitullin e gjashtë nuk janë konkurrencte me tarifatat e rajonit.

Si rezultat, ARH paralel me përgjigjen që i ka kthyer ndërmarrjes hekurudhore Railtrans, ka dhënë edhe opinionin përfundimtar sa i përket këtij drafti të ERR-së:

“Se tarifatat duhet të jenë konkurrencte me rajonin”. Organi i Rregullimit Tregut, sugjeronë MI-në dhe MZHE-në që të veprojnë sipas Nenit 61, pika 3 e Ligjit për Hekurudha, ku thot se pagesat e infrastrukturës, struktura e sistemit të vendosjes së çmimit për shfrytëzuesit e rrjetit dhe niveli i përgjithshëm i pagesave të shfrytëzimit propozohet nga menaxheri i infrastrukturës në pronësi të shtetit dhe e miraton ministria në bashkëpunim me ministrinë përkatëse për ndërmarrjet publike. Menaxheri i infrastrukturës në shfrytëzim të përbashkët në pronësi shtetërore cakton pagesat dhe kostot në përputhje me situatën e tregut, duke respektuar parimin e mos diskriminimit.

Bazuar në Ligjin për Hekurudha, Neni 61.3, i cili ka të bëjë me përcaktimin e tarifave për shërbimet hekurudhore, ARH ka analizuar draft Ekspozeun e Rrjetit 2018, ku me datë 28.06.2017 ka mbajtur takim konsultativ me palët e interesit: MI, MZHE, Infrakos, Trainkos dhe Railtrans, për draft ERR 2018 Shqyrtimi i “Ekspozeut të Rrjetit”

Takimi ishte vazhdimësi e konsultimeve të mëhershme, ishte me qëllim të aprovimit të zbritjes së çmimeve, ku Trainkos kishte paraqitur vërejtjet në takimin e mëparshëm, ndërsa Railtrans kishte bërë ankesë në lidhje me tarifat e larta të cilat ishin caktuar nga Infrakos. Në përputhje me procedurat e parapara ky takim ishte i një rëndësie të madhe lidhur me draft ERR 2018, sepse kemi të bëjmë me ndryshimin e këtij drafti të adaptuar sipas kërkesave nga takimi konsultues ndërmjet palëve të interesit, në bazë të kalkulimeve dhe analizave të bëra dhe me qëllim të përmbylljes sa më të shpejtë të këtij procesi efikas dhe transparent të konsultimeve sipas Nenit 55 dhe 58 të Ligjit për Hekurudha.

Takimi punues për shqyrtimin dhe konsultimin përfundimtar të ERR 2018, pikërisht pjesa e gjashtë “Detyrimet,, ku në bashkëpunim me palët e interesit u bënë përmirësimet e nevojshme dhe të domosdoshme, në pikat e caktuara ku kanë qenë të nevojshme dhe të domosdoshme siç është dhënë në draftin fillestar të ERR 2018, ku kosto direkte për mirëmbajtjen e infrastrukturës ishte 2.6 Mil/€, ndërsa nga tarifat e rishikuar në këtë draft ERR 2018 pritet të inkasohet vlera prej rreth 1.1 Mil. €, kurse pjesa e mbetur nga kosto direkte e mirëmbajtjes në vlerë prej 1.5 Mil. €, parashihet të mbulohet nga Qeveria. ARH ka përgatitur draft Udhëzimin Administrativ për detajimin e kostos direkte në lidhje me mirëmbajtjen e infrastrukturës dhe operimin e shërbimeve të trenit, ku ky draft është dërguar në Ministrinë e Infrastrukturës për nënshkrim.

• Shqyrtimi i ankesës për blerjen e shërbimeve të mirëmbajtjes dhe magazinimit të lokomotivës

ARH, pas pranimit të ankesës së operatori privat Railtrans ndaj kompanisë operuese Trainkos, për mos ofrimin e shërbimeve të mirëmbajtjes ka realizuar disa takime me përfaqësuesit e Railtrans-it dhe Trainkos-it. Gjatë periudhës së shqyrtimit të ankesës së Railtrans-it kundrejt Trainkos-it, ARH ka marrë informata dhe fakte të reja se operatori privat Railtrans ka shfrytëzuar binarët (hapësirën) e Infrakosit për qëllime të mirëmbajtjes dhe parkingut, improvizuar sipas nevojave të veta.

Bazuar në këto informata ARH ka realizuar një takim zyrtar me Infrakos-in, me qëllim të vërtetimit të këtyre informatave, ku u njoftuam se ekziston marrëveshja ndërmjet menaxherit të infrastruktures Infrakos dhe Railtrans-it, për dhënien me qira të binarëve

(hapësirës) me qëllim të mirëmbajtjes dhe parkimit të mjeteve lëvizëse në pronësi të Railtrans-it.

Pas përfundimit të takimit, është inspektuar binari (hapësira) e dhënë me qira nga Infrakos-i për operatorin privat Railtrans. Gjatë inspektimit u vërtetua se ekziston marrëveshja që implementohet nga të dy palët nënshkruese.

Si rrjedhojë e kësaj, ne erdhëm në përfundim se operatorit privat Railtrans i ofrohen të gjitha mundësitë për kryerjen e të gjitha shërbimeve të mirëmbajtjes, servisimit dhe parkimit për nevojat e veta.

Raporti për Monitorimin e Tregut Hekurudhorë

ARH në kuadër të kompetencave ligjore, njërën nga përgjegjësitë kryesore e ka monitorimin e tregut hekurudhor në vend. Në kuadër të kësaj përgjegjësie dhe konform planit të punës, është përgatitur Raporti për Monitorimin e Tregut, ku në detaje ka paraqitur të dhënat e gjetura nga tereni dhe nga burime të ndryshme të informacionit prej entiteteve që merren me statistika dhe analiza të transportit në përgjithësi. Duke qenë se ARH është anëtare me të drejta të barabarta në Grupin e Rregullatorëve të Pavarur Hekurudhor Evropian (IRG Rail), Raporti i Monitorimit të Tregut në baza vjetore dërgohet edhe në IRG Rail.

Fusha Ligjore

Njëra nga aktivitetet në fushën ligjore ka qenë mbështetja e Bordit Mbikëqyrës të ARH - së dhe departamenteve profesionale në hartimin e akteve të reja nënligjore si dhe amandamentimin e atyre ekzistuese. Në fillim vit, kemi qenë pjesë e grupit punues në kuadër të Ministrisë së Infrastrukturës për plotësim/ndryshimin e Udhëzimit Administrativ

Nr. 02/2012 për Licencimin e Operatoreve Hekurudhor dhe atë 03/2012 për Licencimin e Menaxhereve të Infrastrukturës Hekurudhore, brenda territorit të Republikës së Kosovës. Si rezultat i punës së grupit punues, përfshirë Departamentin Ligjor të ARH-së është arritur që me sukses të plotësohen dhe ndryshohen të dy aktet nënligjore të lartpërmendura, ku ndryshimet me të mëdha janë bërë tek Udhëzimi Administrativ për Licencimin e Operatoreve Hekurudhor, konkretisht tek pjesa që ka të bëjë me njohjen e licencave hekurudhore evropiane.

Gjatë vitit raportues është inicuar përfunduar plotësim ndryshimi i Rregullorës së Brendshme të Punës së ARH-së. Plotësim ndryshimi i kësaj rregulloreje ka marrë kohë të konsiderueshme, mirëpo e cila është arritur që të finalizohet brenda vitit 2017.

Po ashtu ARH ka hartuar disa rregullore të cilat kanë qenë pjesë e agjendës legjislative për vitin 2017. Këto rregullore janë draftuar si akte nënligjore të reja, të cilat janë po ashtu në agjendën e zbatimit të MSA-së si dhe të ndërlidhura drejtpërsëdrejti me procesin e Integritimeve Evropiane. Rregulloret në fjalë kanë qenë:

4. Rregullore për Llogaritjen e Kostos Direkte;
5. Rregullore për Metodat e Përbashkëta të Sigurisë (MPS) për Vlerësim dhe Llogaritje të Rrezikut;
6. Rregullore Nr. 04/2017, për Metodat e Përbashkëta të Sigurisë për Vlerësimin e Konformitetit me kërkesat për marrjen e Autorizimit të Sigurisë hekurudhore;
7. Rregullore për Ndërtim, Përmirësim, Rinovim, Vlerësim të Konformitetit dhe Autorizimin për Vendosjen në Shërbim të Mjetit Lëvizës; si dhe
8. Rregullore për të Drejtat e Udhëtarëve në Transportin Hekurudhor.

Pas hartimit të rregulloreve të lartcekura, të njëjtat janë trajtuar fillimisht brenda ARH-së dhe pastaj në respektim të dispozitave ligjore në fuqi, janë dërguar për konsultim publik tek palët e interesit. Mbi bazën e komenteve dhe rekomandimeve, ARH-ja ka përgatitur draftin final dhe shumica nga to janë aprovuar nga Bordi Mbikëqyrës i ARH-së.

Gjatë vitit 2017 ARH është përfaqësuar në konteste gjyqësore, nga Departamenti Ligjor. Vlenë të përmendet rasti i aksidentit me fatalitet i ndodhur në vitin 2012 në territorin e Komunës së Pejës. Mbi bazën e super-ekspertizës së bërë në këtë rast, është konstatuar se përgjegjësia për aksidentin në fjalë është e ndarë në mes të Hekurudhave të Kosovës (trashëgimtar ligjor të HK janë Infrakos dhe Trainkos) dhe viktimës. Marrë shkas nga konkludimi i super-ekspertizës, përfaqësuesit ligjor të familjes së viktimës, kanë zgjeruar

padinë në drejtim të disa institucioneve, në mesin e të cilave edhe ndaj ARH-së. Ky rast vazhdon të jetë në trajtim e sipër në Gjykatën Themelore të Pejës.

Ngjashëm sikurse në vitet paraprake, ARH ka qenë e angazhuar rreth aktiviteteve të cilat ndërlidhën me procesin e integriteteve evropiane të Republikës së Kosovës. Këto aktivitete kanë qenë kryesisht të fokusuara në:

- a. Përgatitjen e raporteve tre mujore lidhur me zbatimin e Planit Kombëtar për Marrëveshjen e Stabilizim Asociimit. Obligime të cilat parashihen me këtë marrëveshje në rrugën e Kosovës drejtë integriteteve evropiane;
- b. Përgatitjen dhe dërgimin e Narrativit për takimin e DPSA-së në Bruksel tek Komisioni Evropian, për raportim të drejtpërdrejtë për sektorin hekurudhor në Republikën e Kosovë;
- c. Përgatitja e Narrativëve së bashku me veprimet pasuese për vitin 2018, në kuadër të procesit integruar, të paraparë me Marrëveshjen e Stabilizim Asociimit mes Kosovës dhe BE-së;
- d. Raportimi në Këshillin Ministror për Integritete Evropiane, lidhur me përmbushjen e kushteve ligjore të parapara me agjendën për qeverisje të mirë mes Republikës së Kosovës dhe BE-së;
- e. Informimi i Agjencionit Evropian të Hekurudhave lidhur me transpozimin e Direktivës së BE-së për licencim të makinistëve 2007/59, ku kemi shpjeguar edhe nenet relevante të ligjit të cilat e kanë transpozuar këtë direktivë;
- f. Gjatë gjithë vitit 2017 kemi qenë në kontakt dhe të angazhuar drejtpërsëdrejti lidhur me aktivitetet dhe kërkesat e SEETO-s për sektorin hekurudhor në Evropën Juglindore; si dhe
- g. Fillimi i adresimit të obligimeve të cilat rrjedhin nga Traktati i Konektiviteti i lidhur me vendeve të Ballkanit Perëndimore dhe BE-së.

ARH, gjatë vitit 2017 ka përcjell me kujdes zbatimin e akteve nënligjore të mëposhtme, të nxjerra gjatë viteve të mëhershme, siç janë:

1. Udhëzimi Administrativ Nr. 02/2012 për Licencimin e Ndërmarrjeve Hekurudhore;
2. Udhëzimi Administrativ Nr. 03/2012 për Licencimin e Menaxherëve të Infrastrukturës;

3. Udhëzimi Administrativ Nr. 04/2012 për Dhënien e Certifikatës dhe Autorizimit të Sigurisë për Ndërmarrjet Hekurudhore dhe Menaxherët e Infrastrukturës Hekurudhore;
4. Rregulloren Nr. 0/2012 për Licencimin e Menaxherëve dhe Ndërmarrjeve Hekurudhore;
5. Rregullore Nr. 03/2012 për Certifikatat e Sigurisë;
6. Rregullore Nr. 04/2012 për Autorizimin e Sigurisë;
7. Rregullore Nr. 05/ 2012 për Regjistrin Nacional të Mjeteve Lëvizëse Hekurudhore;
8. Rregullore Nr. 06/ 2012 për Regjistrimin e Infrastrukturës;
9. Rregulloren 01/2013 për Ekspozeun e Rrjetit;
10. Rregulloren 02/2013 për Licencimin e Makinistëve;
11. Rregullorën 01/2017 për Taksa dhe Gjoha;
12. Rregulorën 02/2017 për Të Drejtat e Udhëtarëve në Transportin Hekurudhor;
13. Rrregullorën 03/2017 për Monitorimin e Tregut Hekurudhor;
14. Rregullorën Nr. 04/2017, për Metodën e Përbashkëta të Sigurisë për Vlerësimin e Konformitetit me kërkesat për marrjen e Autorizimit të Sigurisë hekurudhore; si dhe
15. Rregullorën Nr. 05/2017, Metodën e Përbashkëta të Sigurisë (MPS), për Vlerësim dhe Llogaritje të Rrezikut.

Në fushë ligjore, ARH do të vazhdojë me përkushtimin maksimal që të sigurojë ligjshmërinë në zbatimin e të gjitha akteve nënligjore të nxjerra, në mënyrë që sektori hekurudhor në Republikën e Kosovës të rregullohet dhe mbikëqyret konform praktikave më të mira rajonale dhe ato të Bashkimit Evropian. Për vitin 2018 kemi paraparë një agjendë konkrete dhe dinamike në hartimin dhe nxjerrjen e akteve nënligjore të nevojshme për rregullimin dhe mbikëqyrjen e sektorit hekurudhor nga ana e ARH-së, duke u bazuar edhe në kërkesat që rrjedhin nga obligimi i zbatimit të MSA-së, Traktatin e Konektivitetit dhe agjendën evropiane në përgjithësi.

Administrata

ARH, përkujdeset që të gjitha proceset administrative të jenë në përputhje me rregullativen ligjore të zbatueshme në Republikën e Kosovës dhe t'i përgjigjet të gjitha kërkesave të adresuara në kuadër të ARH-së, siç janë:

- **Mbështetja e përgjithshme për strukturat e ARH-së;**
- **Menaxhimi i burimeve njerëzore;**
- **Mirëmbajtja e teknologjisë informative; si dhe**
- **Administrimi i Arkivës;**

Gjatë ushtrimit të detyrave dhe përgjegjësive në fushën e menaxhimit të burimeve njerëzore jemi të obliguar që t'i zbatojmë të gjitha aktet ligjore dhe nënligjore që kanë të bëjnë me Shërbimin Civil. Stafi i ARH-së janë shërbyes civil sipas ligjit, me përjashtim të anëtarëve të Bordit Mbikëqyrës të cilët janë të emëruar publik. Në këtë fushë jemi të obliguar të bashkëpunojmë me Departamentin e Administrimit të Shërbimit Civil në kuadër të Ministrisë së Administratës Publike si dhe me Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës të Shërbimit Civil, si organ mbikëqyrës i zbatimit të legjislacionit të Shërbimit Civil.

Gjatë ushtrimit të detyrave dhe përgjegjësive në mbikëqyrjen e logjistikës dhe pasurisë së ARH-së, zbatohen rregulloret e nxjerrura nga Ministria e Administratës Publike. Po ashtu gjatë ushtrimit të detyrave dhe përgjegjësive në administrimin e arkivës dhe librit të protokollit, ARH zbaton Ligjin për Administrimin e Punëve në Zyrë dhe akte nënligjore që rrjedhin nga ky ligj.

Financat

Duke njohur nevojën për përmirësimin e shpenzimeve buxhetore, kapitale dhe operative, menaxhimit financiar, kontabilitetit, përgjegjësive buxhetore dhe sistemit të raportimit financiar, ARH vepron dhe operon në bazë të: Ligjit Nr.03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë.

Gjatë vitit raportues, ARH për herë të parë ka filluar edhe me inkasimin e të hyrave si rezultat i ofrimit të shërbimeve të saj në fushën e licencimit, sigurisë, rregullimit të tregut dhe interoperabilitetit. Këto të hyra bazohen në Ligjin e Hekurudhave dhe Rregullorën Nr.

01/2017 për Taksa dhe Gjoha. Menaxhimi i këtyre të hyrave nga ana e ARH-së bëhet duke u bazuar në Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë si dhe akteve tjera nënligjore në këtë fushë.

i. Pasqyrat financiare

Në formë tabelare janë paraqitur pasqyrat financiare dhe rrjedhshmëria e transaksioneve financiare të ARH-së sipas kategorive buxhetore.

Tabela 14. Pasqyrat financiare për vitin 2017

Përshkrimi	Buxheti i aprovuar-fillestar	Buxheti i aprovuar-final-pas shkurtimeve buxhetore	Shpenzimet	Shpenzimet %
Paga dhe mëditje	177,744.00	187,744.00	180,726.45	96.26 %
Mallra dhe shërbime	114,179.00	119,679.00	104,721.52	87,50 %
Shpenzime komunale	11,900.00	6,400.00	6,302.28	98,47 %
Gjithsej	303,823.00	313,823.00	291,300.25	92,82 %

Për një sqarim të përgjithshëm do të japim një gjendje të përgjithshme financiare dhe një ndarje krahasuese për të gjitha kategoritë buxhetore, duke paraqitur të dhënat e vitit paraprak, të cilat na japin një pasqyrë më të mirë, më të qartë dhe më me vizion për të ardhmen e ARH-së.

Ndarjet buxhetore në total nga të gjitha Kategoritë Buxhetore, Varianca dhe Krahasimet

Pasqyra e krahasimit të shumave buxhetore dhe aktuale për ARH
Për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2017

Shënime	2017				2016	2015
	Buxheti fillestar	Buxheti final	Realizimi	Varianca	Realizimi	Realizimi
	(Ndarja)	(Ndarja)		D=C-B	E	F
	A	B	C	€	€	€
Hyrja e parasë së gatshme në llogari të Thesarit						
Tatimet 14						
Të hyrat vetanake 15						
Donacionet 16						
Pranimet kapitale 17						
Fondi i Privatizimit 18						
Huazimet 19						
Tjera 20						
Pranimet totale të mbledhura për FKK-në	-	-	-	-	-	-
Daljet e parasë së gatshme nga llogaritë e Thesarit						
Pagat dhe mëditjet 21	177,744.00	187,744.00	180,726.45	7,017.55	124,917.77	123,269.94
Mallrat dhe shërbimet 22	114,179.00	119,679.00	104,271.52	15,407.48	70,337.36	108,659.24
Shërbimet komunale 23	11,900.00	6,400.00	6,302.28	97.72	5,996.37	5,973.68
Transferet dhe subvencionet 24				-		
Shpenzimet kapitale 25	-	-	-	-	-	-
Fondi i privatizimit 26						
Kthimi i huazimeve 27						
Tjerat						
Totali i pagesave i bërë nga BRK nëpërmes LIVTh	303,823.00	313,823.00	291,300.25	22,522.75	201,251.50	237,902.86

Vëmendje:1/Ndryshimet buxhetore finale nga këto fillestare janë si rezultat i ndryshimeve buxhetore nga niveli qendror,nevojave të brendshme konform kërkesave reale dhe përshtatjes së planifikimit final tek kodet ekonomike (ku nga pagat kemi pas një mbështetje prej 10,000.00 euro, poashtu ka pasur transfer prej 5,500.00 euro nga kategoria e Komunalisë në kategori të Mallrave dhe shërbimeve).

Paga: Kemi një realizim të buxhetit prej **96.26 %**

Raport vjetor 2017

Përshkrimi	2017				2016	2015
	GQ €	THV €	GPD €	Totali €	€	€
Pagesat						
Neto pagat		151,963.53	-	151,963.53	106,109.07	104,701.08
Pagesat për sindikata -0.10% te 0.50%						
Pagesa neto për punë jashtë orarit						
Pagesa për punë me orar të shkurtuar						
Pagesa për punë në ndërrim të natës						
Pagesa neto për pushim të lehonisë						
Mëditjet e delegatëve dhe komisioneve						
Punëtorët me kontratë						
Tatimi në të ardhura personale		11,550.54	-	11,550.54	6,911.76	6,828.38
Pagesa e kontributit pensional nga punëdhënësi		8,606.19	-	8,606.19	5,948.47	5,870.24
Pagesa e kontributit pensional nga i punësuar		8,606.19	-	8,606.19	5,948.47	5,870.24
Shujtat						
Gjithsej Pagesat	-	180,726.45	-	180,726.45	124,917.77	123,269.94

Mallra dhe Shërbime: Kemi një realizim të buxhetit prej **87,50 %**

Përshkrimi	GQ	THV	GPD	Totali	€	€
	€	€	€	€		
Pagesat						
Shpenzimet e udhëtimit	28,605.47			28,605.47	16,247.69	28,469.72
Shërbimet e telekomunikimit	8,485.00			8,485.00	6,360.00	5,611.00
Shpenzimet për shërbime	15,015.00			15,015.00	5,302.70	11,114.94
Shërbime kontraktuese tjera	2,753.41			2,753.41		
Mobiljet dhe pajisjet nën 1000 Euro	99.00			99.00	491.70	40.37
Mobiljet dhe pajisjet tjera 1000 - 5000 Euro	3,160.00			3,160.00		
Blerje tjera të mallrave dhe shërbimeve	5,852.14			5,852.14	3,936.18	10,804.50
Derivatet dhe lëndët djegëse	5,950.51			5,950.51	7,528.94	7,826.53
Shërbimet financiare	-			-		
Shërbimet e regjistrimit dhe sigurimeve	8,527.29			8,527.29	7,261.15	6,865.00
Mungesa në arkë-kthimet	-			-		
Mirëmbajtja	4,479.80			4,479.80	4,919.97	10,796.70
Qiraja	19,373.00			19,373.00	17,683.33	21,125.00
Shpenzimet e marketingut	602.30			602.30	462.70	1,226.30
Shpenzimet e përfaqësimit	1,368.60			1,368.60	143.00	1,470.30
Vendimet e gjykatave	-			-	-	3,308.88
Tatimi						
Servisimi i borxhit						
Gjithsej Pagesat	104,271.52	-	-	104,271.52	70,337.36	108,659.24

Sqarim: Tek kategoria e Mallrave dhe shërbimeve janë të përfshira edhe obligimet e mbetura në fundvit (dhjetori i vitit paraprak) për shkak të mbylljes së sistemit të pagesave nga MF ku kryesisht janë si shpenzimet për shërbime-të kontraktuara, blerje tjera të mallrave dhe shërbimeve- furnizimeve si dhe shpenzime nga qiraja

Shpenzime Komunale:Kemi një realizim të buxhetit prej **98.47 %**

Përshkrimi	2017			Totali	2016	2015
	GQ	THV	GPD			
	€	€	€	€	€	€
Rryma	3,400.00			3,400.00	3,129.72	2,982.48
Uji						
Telefon	2,902.28			2,902.28	2,866.65	2,991.20
Gjithsej Pagesat	6,302.28	-	-	6,302.28	5,996.37	5,973.68

Sqarim: Poashtu tek kategoria e Shpenzimeve komunale janë të përfshira edhe obligimet e mbetura në fundvit (dhjetori i vitit paraprak) për shkak të mbylljes së sistemit të pagesave nga MF,ku si shpenzime janë shpenzimet e rrymës.

Të hyrat vetanake

Përshkrimi	Shënime	2017	2016	2015	% e totalit	% e ndryshimit
		€	€	€		
Të hyrat nga taksat 1 të ARH-së		2,450.00			%	%
Të hyrat nga taksat 2 të ARH-së					%	%
Të hyrat nga dënimet-gjobat 1 të ARH-së					%	%
Të hyrat nga dënimet-gjobat 2 të ARH-së					%	%
Të hyrat nga licencat 1 të ARH-së					%	%
Të hyrat nga licencat 2 të ARH-së					%	%
Të hyrat nga shitja e pasurisë dhe shërbimeve					%	%
Të hyrat nga inspektimi					%	%
Të hyrat nga interesi bankar					%	%
Të hyrat nga ndryshimet e pozicionit të kursit					%	%
Tarifa për akreditim					%	%
Të hyrat nga pasuria e ARH-së					%	%
Pranimet tjera të ARH-së					%	%
Totali		2,450.00	0	0	0%	%

ARH gjatë vitit 2017 ka filluar inkasimin e mjeteve përmes Taksave, Gjobave, Licencave, Lejeve të Sigurisë dhe pranimet tjera si të Hyra Institucionale.

Subvencione dhe Transfere

Përshkrimi	2017				2016	2015
	GQ €	THV €	GPD €	Totali €	€	€
Pagesat						
Subvencionet për entitetet publike						
Subvencionet për entitetet kulturore						
Subvencionet për entitetet jo-publike						
Transfere për qeveri tjera						
Pagesat për përfituesit individualë						
Pensionet bazë						
Pensionet invalide						
Pensionet ose ndihmat sociale						
Pensionet e TMK-së						
Pensionet e kategorisë I (anëtarët e familjes)						
Pensionet e kategorisë II (anëtarët e familjes)						
Pagesat për invalidët e luftës						
Pagesat për invalidët civilë						
Pagesat për familjet e viktimave të luftës						
Pensionet e përkohshme të Trepçës						
Vendimet gjyqësore						
Gjithsej Pagesat	-	-	-	-	-	-

Gjatë këtij viti nga kjo kategori nuk kemi pasur ndonjë përkrahje apo subvencion as nga Qeveria as nga Donatorët apo ndonjë nivel tjetër.

Shpenzimet Kapitale

Përshkrimi	2017				2016	2015
	GQ €	THV €	GPD €	Totali €	€	€
Pagesat						
Ndërtesat					-	-
Ndërtimi i rrugëve					-	-
Kanalizimi					-	-
Ujësjellësi					-	-
Energjia, gjenerimi, bartja dhe furnizimi					-	-
Pajisje mbi 1000 Euro					-	-
Automjete transporti					-	-
Makineria-Blerja e veturës zyrtare		-		-	-	-
Kapitalet tjera					-	-
Toka						
Pasuritë e paprekshme						
Transferet kapitale për entitetet publike						
Transferet kapitale për entitetet jopublike						
Vendimet gjyqësore						
Gjithsej Pagesat	-	-	-	-	-	-

5.7.1.1. Detajet e shpenzimeve nga kategoritë e Pagave, Mallrave dhe Shërbimeve, Shpenzimeve Komunale dhe Shpenzimeve Kapitale për vitin 2017 (Janar- Dhjetor 2017)

Kodet ekonomike	Planifikimi/Ndarja fillestare dhe finale		Realizimi
	Fillestare	Finale	
6-11000 · PAGAT & MEDITJET			
6-11110 · Paga Bruto Përmes Payr			151,963.53
6-11115-Pagesa për sindikata			0.00
6-11500-Tat.i ndaluar ne te ardhura personale			11,550.54
6-11600 · Kontributi pensional nga punëtori			8,606.19
6-11170-Kontributi për pension nga punëdhënësi			8,606.19
Total 6-11000 · PAGAT & MEDITJET	Fill/177,744.00	Fin/187,744.00	180,726.45
6-13000 · MALLRAT & SHERBIMET			
6-13100 · Shpenzimet e Udhetimit	31,500.00		
6-13143 · Shpenz.e udhet.jashte vendit			0.00
6-13133 · Shpenz.tjera udhet.zyratar mbre			0.00
6-13142 · Akomodim gjate udhetimit zyrtar			1070.28
6-13141 · Meditjet e udhetimit zyrtar			6999.93
6-13140 · Sh. Udhetimit Jasht Ven			20,535.26
Total 6-13100 · Shpenzimet e Udhetimit			
71706 kthim i mjeteve(avansi)			0.00
71041 kthim i mjeteve(avans regj Pr NLB)			0.00
6-13300 · Sherbimet e Telekomunikimit	8,000.00		
6-13310 · Interneti			0.00
6-13320 · Shpenzimet Tjera Telefo			8,485.00
6-1320A · M			
6-1320B · R			
Total 6-13320 · Shpenzimet Tjera Telefo			0.00
6-13330 · Komunikimet Tjera			
6-13330 - Dergesat postare			
Total 6-13330 · Komunikimet Tjera			
Total 6-13300 · Sherbimet e Telekomunikimit			
6-13400 · Sherbimet Kontraktuese	15,000.00		
6-13480-Shpenzimet per antarsim			
6-13460 · Sherb.tjera kontr.			2,753.41
6-13450- Sherbime shtypje-jomarketing			0.00
6-13410 · Sh. Arsimit & Trajnimit			15,015.00
6-13430 · Sh.Ndryshme Shendetesor			
6-13440 · Sh.Ndryshme intel,keshilldh			0.00

6-13470 · Sherbimet Teknike		0.00
Total 6-13400 · Sherbimet Kontraktuese		
6-13500 · Blerja e Mobilie. >1000		
6-13501 · Mobilie		99.00
6-13502 · Tel mobil		1360.00
6-13503 · Kompjuter		1800.00
6-13509 · Paisje Tjera		0.00
Total 6-13500 · Blerja e Mobilie. >1000		0.00
6-13600 · Blerje Tjera	8,000.00	
6-13660 · Akomodim		
6-13610 · Furnizime per Zyre		2,533.41
6-13620 · Furnizim me ushqim & pi		3,318.73
6-13640 · Furnizime Pastrimi		
6-13650 · Furnizime me veshmbathj		0.00
Total 6-13600 · Blerje Tjera		
6-13700 · Derivate & Lend djegese	14,379.00	
6-13780 · Karburant per Vetura		3,232.96
6-13770 · Karburant per gjenerator		
6-13720 · Naftë per ngrohje		2,717.55
Total 6-13700 · Derivate & Lend djegese		
6-13800 · Llogarit e Avansit		
6-13820 · A. per udhetime zyrtare		
Total 6-13800 · Llogarit e Avansit		
6-13900 · Sherbimet Financiare		
6-13950 · Rexhistrimi i automjeteve	9,500.00	1,112.31
6-13952 · Taksa komunale e regjistrimit		0.00
6-13951 · Sigurimi i Automjeteve		0.00
6-13953 · Sigurimi I Ndertesave dhe tjera		7,414.98
Total 6-13900 · Sherbimet Financiare		
6-14000 · Mirembajtja		
6-14031 · Mirembajtja e rrugeve regjional	6,800.00	
6-14010 · Mir.&Riparimi Autmjeteve		1,353.80
6-14020 · Mir. e Ndertesave		2,791.00
6-14030 · Mir. Infrastruktures Rr		
6-14040 · Mir. Teknologjis Inform		0.00
6-14050 · Mir. Mobilive & Paisjev		335.00
Total 6-14000 · Mirembajtja		
6-14100 · Qiraja		
6-14110 · Ndertesat	19,500.00	19,373.00
Total 6-14100 · Qiraja		
6-14200 · Shpenzimet e Marketingu		
6-14230 · Shpenz.per informim publik	500.00	602.30

Raport vjetor **2017**

6-14210 · Reklama dhe Konkurse 6-14220 · Botime dhe Publikime Total 6-14200 · Shpenzimet e Marketingu		0.00
6-14300 · Shpenzimet e Perfaqesim 6-14310 · Drekat Zyrtare Total 6-14300 · Shpenzimet e Perfaqesim	1,000.00	1,368.60
6-14400 · Shpenzimet per vendim dhe gjyka 6-14410 · Shpenzimet per vendim te gjykat Total 6-14400		0.00
Total 6-13000 · MALLRAT & SHERBIMET	Fill/114,179.00 Fin/119,679.00	104,271.52
6-13200 · SHPENZIMET KOMUNALE 6-13210 · Rryma 6-13220 · Uji 6-13230 · Mbeturinat 6-13240 · Ngrohja Qendrore 6-13250 · Telefoni PTK Total 6-13200 · SHPENZIMET KOMUNALE	Filestare Finale 7,400.00 500.00 0.00 4,000.00 Fill/11,900.00 Fin/6,400.00	3,400.00 2,902.28 6,302.28
6-20000 · Subvencionet&Transferet 6-21110 · Su. per Entitetet Publi 6-22200 · Pag. Perfitues Individu Total 6-20000 · Subvencionet&Transferet		
6-30000 · SHPENZIMET KAPITALE 6-31210 · Ndertimi i Autostrade 6-31230 · Ndertimi i rrugeve lokale 6-31220 · Ndertimi i rrugeve regjionale 6-31700 · Vetura zyrtare 6-31910 · Avanc per Investime Total 6-30000 · SHPENZIMET KAPITALE		0.00 0.00
Totali	Fill/303,823.00 Fin/313,823.00	291,300.25

Prokurimi

ARH, sipas obligimeve ligjore ka bërë përgatitjen e Planifikimit të Prokurimit, në të cilin janë paraparë të gjitha kërkesat për blerjen e mallrave, shërbimeve dhe punëve në bazë të kërkesave të pranura nga të gjitha njësitë e kërkesës.

Në kuadër të detyrave dhe përgjegjësiave tona, sipas Planifikimit Përfundimtar të Prokurimit për vitin 2017, dokument standard i aprovuar nga KRPP dhe sipas Planit të Punës për vitin 2017, mbi bazën e të cilit janë kryer të gjitha aktivitetet e parapara të prokurimit, janë parapa të realizohen gjithsejtë 14 aktivitete të prokurimit për blerjen e mallrave dhe shërbimeve të nevojshme për funksionimin e ARH-së, prej të cilave 12 (dymbëdhjetë) janë realizuar ndërsa për 2 (dy) aktivitete tjera nuk janë iniciuar kërkesat për zhvillim të procedurave për shkak të mungesës së mjeteve financiare. Ndërsa si aktivitete të realizuara të cilat nuk kanë qenë të parapara në Planin e Punës për vitin 2017 janë po ashtu 2 (dy). Sipas Nenit 21A të Ligjit 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092, është bërë përgatitja dhe kompletimi i kërkesave me dokumentacionin përcjellës për të kërkuar nga AQP iniciimin dhe zhvillimin e të gjitha aktiviteteve sipas planifikimit dhe nevojave të ARH-së.

ARH në mënyrë të vazhdueshme ka një bashkëpunim të ngushtë dhe efikas me Komisionin Rregullativ të Prokurimit Publik dhe me Agjencinë Qendrore të Prokurimit.

Marrëdhëniet me Publikun dhe Qasja në Dokumente Publike

Me qëllim të planifikimit dhe koordinimit të Komunikimit me Publikun përmes bashkërendimit të planeve të komunikimit me planin vjetor të punës së Departamenteve të ARH-së, zbatimit të plotë të Ligjit 03/L-215, për Qasje në Dokumente Publike dhe Rregullores Nr. 03/2011 – për shërbimin e komunikimit qeveritar me publikun, ARH është e hapur me transparencë të plotë gatishmëri për bashkëpunim me çdo mekanizëm,

institucion apo organizatë që për qëllim ka ngritjen e nivelit të përgjegjësisë në Institucionet Publike.

Me qëllim të implementimit të Ligjit për Qasje në Dokumente Publike, ne si ARH i jemi përgjegjës në formën më të mirë të mundshme dhe në harmoni të plotë me ligjin çdo kërkesë që kemi pranuar për qasje në dokumente publike. Marrë për bazë natyrën e veprimtarisë profesionale të ARH-së si dhe kufizimet buxhetore, ne si institucion nuk kemi pas mundësi të bëjmë organizimin e ndonjë aktiviteti i cili ndërlidhet direkt me zbatueshmërinë dhe implementimin e Ligjit për Qasje në Dokumente Publike, por për të qen sa më transparent dhe për ta bërë më të lehtë komunikimin me publikun ARH ka të caktuar Zyrtarin Përgjegjës për Komunikim me Publikun dhe Qasje në Dokumente Publike, ka ueb faqen zyrtare funksionale në të cilën paraqiten të gjitha aktivitetet e ARH-së, raportet vjetore si dhe janë të publikuara informata me interes publik të cilat e orientojnë publikun për të drejtat e tij dhe mënyrën për qasje në dokumente publike/zyrtare. Natyrisht se sikur në çdo fushë tjetër edhe në këtë fushë ka sfida të ndryshme të cilat paraqiten gjatë implementimit të Ligjit për Qasje në Dokumente Publike, por me një koordinim më të mirë ndërinstytucional dhe me një angazhim më të madh të institucioneve relevante konsiderojmë se do të tejkaloheshin edhe sfidat të cilat paraqiten gjatë implementimit të Ligjit për Qasje në Dokumente Publike.

Të dhënat e detajuara lidhur me kërkesat për Qasje në Dokumente Publike drejtuar ARH-së, janë paraqitur në tabelat e mëposhtme.

○ **Tabela 8:** Numri i kërkesave të pranuar

Numri i kërkesave të pranuar			
Numri total	Qasje e lejuar	E refuzuar	E pjesshme
6	3	1	2

○ **Tabela 9:** Qasje e lejuar

Qasje e lejuar	Numri
Në afat, sipas ligjit	3
Me pagesë	0
Pa pagesë	3

○ Tabela 10:

Qasja e refuzuar	Numri
E plotë	1
E pjesshme	2
Pa përgjigje	0

○ Tabela 11:

Kërkesat për rishqyrtim	Numri
Numri total i rishqyrtimeve	1
E lejuar	0
E refuzuar	1
E pjesshme	0

| Numri i aktvendimeve të lëshuara për refuzim: **1 (një)**

○ Tabela 12:

Refuzimet dhe qasjet e kufizuara	Numri
2. Përfashtimet nga neni 12 :	
(specifikoni cila pikë, nga lista e mëposhtme)	
1.1. sigurisë kombëtare, mbrojtjes dhe marrëdhënieve ndërkombëtare;	
1.2. sigurisë publike;	
1.3. parandalimit, hulumtimit dhe ndjekjes së aktiviteteve penale;	
1.4. hulumtimeve disiplinore;	
1.5. inspektimit, kontrollimit dhe mbikëqyrjes nga institucionet publike;	
1.6. privatësisë dhe interesave të tjerë legjitim privat;	
1.7. interesave komerciale dhe të tjera ekonomike;	
1.8. politikave ekonomike, monetare dhe këmbimore të shtetit;	
1.9. barazisë së palëve në procedura gjyqësore dhe administrimin efikas të drejtësisë;	
1.10. mjedisit, apo,	
1.11. diskutimeve brenda apo ndërmjet institucioneve publike lidhur me shqyrtimin e ndonjë çështjeje.	x 1 (një)
3. Neni 10. (Pa përgjigje)	
4. Dokumentet e klasifikuara	
5. Të dhënat personale, sipas Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale	
6. Arsye tjera të refuzimeve, (ju lutem specifikoni)	

--	--

5.9.1.1. Kërkesat dhe përgjigjet

Tabela 13:

Kërkesat e paraqitura	Numri
Në mënyrë elektronike	6
Kopje fizike	0
Elektronike dhe kopje fizike	0

Tabela 14:

Mënyra e dërgimit të përgjigjeve	Numri
Në mënyrë elektronike	4
Kopje në letër	0
Elektronike dhe kopje	2
CD	0

5.9.1.2. Profili i aplikuesve dhe dokumentet e kërkuara

I. Tabela 15:

Profili	Numri
Gazetarë	2
Shoqëri civile	1
Organizata buxhetore	2
Individë	1
Studentë	0
Parti politike	0
Tjera (specifiko)	0

II. Tabela 16:

Dokumenti	Numri
Buxhet, shpenzime	2
Vendime	2
Projektligje	0
Statistika	1

Kontrata	1
Projekte	
Konkurse	
Dokumentacioni që ndërlidhet me procesin e Licencimit të Operatorëve, procesin e Certifikimit të Sigurisë dhe procesin e Autorizimit për futje në shërbim	2

Raporti Financiar

Bashkëngjitur si shtojcë gjeni Raportin Financiar të vitit 2017 (sipas formatit të pranuar nga Kuvendi i Kosovës).

Raportimi rreth adresimit të rekomandimeve të zyrës së auditorit të përgjithshëm

Zyra e Auditorit të Përgjithshëm (ZAP) ka kryer auditimin e pasqyrave vjetore financiare të ARH-së për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2017. Ky auditim është fokusuar në pasqyrat vjetore financiare, menaxhimin financiar dhe kontrollin e brendshëm .

Në maj të vitit 2017 ka publikuar Raportin e Auditimit (nr. dokumenti 24.22.1-2016-06) për pasqyrat financiare të ARH-së për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2017. Zyra Kombëtare e Auditimit si konkluzione dhe rekomandime kryesore ka paraqit se duhet të sigurohet se procesi i përgatitjes së PFV 2017 dhe shpalosjeve përfshinë një rishikim menaxherial formal dhe efektiv,të zbatohet një proces rigoroz për të siguruar që procesi i vetëvlerësimit dhe menaxhimi i rrezikut

adresohen në mënyrë efektive dhe reale dhe të sigurohet që aranzhimet e qeverisjes janë rishikuar në mënyrë kritike për t'u siguruar se janë bërë ndryshime adekuate në fushën e planifikimit strategjik.

■ ■ ■ Shtojcat

Shtojca I

Përshkrimi i Hekurudhave të Kosovës

Hekurudhat e Kosovës shtrihen në tërë territorin e Republikës së Kosovës me një gjatësi prej 333,45 km. Në këtë gjatësi nuk përfshihen vijat industriale të cilat kapin gjatësinë prej 103,40 km. Linja e parë hekurudhore në Kosovë është ndërtuar në vitin 1874 në relacionin Hani i Elezit – Fushë Kosovë – Mitrovicë. Më vonë ka filluar dhe është kryer ndërtimi i rrjetit ekzistues hekurudhor nëpër tërë territorin e Kosovës. Linjat hekurudhore bëjnë lidhjen e të gjitha qendrave më të rëndësishme të Kosovës, përveç Gjakovës dhe Gjilanit. Këto linja kanë lidhje të drejtpërdrejt edhe me shtetet fqinje si me Maqedoninë e Serbinë dhe përmes tyre edhe me shtetet e tjera.

Hekurudhat e Kosovës kryesisht ndahen në dy linja:

Linja Veri – Jug:

Shtrihet nga kufiri me Serbinë (Stacioni Leshak) deri në kufirin me Maqedoninë (Stacioni Hani i Elezit), me gjithsejtë 148 km në linjën bazike hekurudhore 10 të SEETO-s (linjë funksionale).

Linja Verilindje - Perëndim:

Përbëhet nga tri degë:

5. **Linja Lindore** - nga kufiri me Serbinë (Stacioni Podujevë) deri në Fushë Kosovë me gjithsejtë 45 km gjatësi,
 - Fushë Kosovë – Bardhosh 15 km (linjë funksionale),
 - Bardhosh-Podujevë 30 km (linjë jo – funksionale),

6. **Linja Perëndimore** nga Fushë Kosova deri në Pejë me gjithsejtë 81 km gjatësi (linjë funksionale),

7. **Linja Jug - Perëndim** nga Klina deri në Prizren me gjithsej 58 km gjatësi,

- Klinë – Xërxe 35 (linjë funksionale),
- Xërxe – Prizren 32.5 (linjë jo – funksionale).

i. Harta e Hekurudhave të Kosovës



SHTOJCË II

Tabela 1: Lloji dhe numri i Licencave të lëshuara nga ARH

<u>Nr</u>	<u>Lloji i Licencës</u>	<u>Sasia</u>	<u>Nr. Licencës</u>	<u>Viti</u>	<u>Lëshuar</u>
1	Licencë për Menaxherin e Infrastrukturës	1	KS 02/2012 0001	2012	ARH
2	Licencë për transport të mallrave dhe udhëtarëve	1	KS 01/2012 0001	2012	ARH
3	Licencë për transport të mallrave	1	KS 01/2014 0001	2014	ARH

Tabela 2: Lloji dhe numri i Autorizimeve/Certifikatave të sigurisë të lëshuara nga ARH

<u>Nr</u>	<u>Lloji</u>	<u>Sasi</u>	<u>Nr. i Autorizimit /Certifikatës</u>	<u>Viti</u>	<u>Lëshuar</u>
10	Autorizimi i Sigurisë, Pjesa A dhe B	1	KS 21 2013 0001 KS 22 2013 0001	2013	ARH
2	Certifikatë e Sigurisë për transport të mallrave dhe udhëtarëve, Pjesa A dhe B	1	KS 11 2013 0001 KS 12 2013 0001	2013	ARH
3	Certifikatë e Sigurisë për transport të mallrave, Pjesa A dhe B	1	KS 11 2016 0001 KS 12 2016 0001	2016	ARH

SHTOJCË III

Korniza ligjore e BE-së e aplikueshme për sektorin e Hekurudhave

Licencimi:

1. Direktiva e BE-së 91/440 për Zhvillimin e Hekurudhave të BE-së,
2. Direktiva e BE-së 95/18 për Licencimin e Ndërmarrjeve Hekurudhore,
3. Direktiva e BE-së 2007/59 për Licencimin dhe Certifikimin e Makinistëve.

Siguria:

- Direktiva e BE-së 2004/49 për Sigurinë e Hekurudhave,
- Rregullorja e BE-së 653/2017 për Procedurat e Marrjes së Certifikatës së Sigurisë.

Rregullimi i Tregut:

1. Direktiva e BE-së 2011/14 për Çmimet dhe Qasjen në Binarë,
2. Direktiva e BE-së 2012/34 për Krijimin e Hapësirën Unike Evropiane të Transportit Hekurudhor,
3. Rregullorja e BE-së 1370/2007 për Kontratën e Shërbimeve Publike.

Interoperabiliteti:

- a. Direktiva e BE-së 2008/57 për Interaporabilitet,
- b. Specifikacionet Teknike për Interoperabilitet STI.